

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7698 E shtunë 3 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
Më 11 nëntor udhëheqës botërorë do të mbledhen në Paris për të kujtuar 100-vjetorin e përfundimit të Luftës së Parë Botërore, një ndër konfliktet më të...

ZËRI I AMERIKËS
Ballkani dhe hija e Luftës I Botërore

Opinion **Ditës**
Dimë se është ide e keqe, por nuk na është ofruar ndonjë tjetër, kështu që me të do të vazhdojmë". Ky ishte përfundimi i një bisede mes dy evropianëve të informuar...

Nga VETON SURROI
Nasradin Hoxha në Bruksel



"Dekreti i Lleshit? Jo vendim formal"

Meta: Saimir Tahiri delinkuent, mbushi jo vetëm Shqipërinë me drogë, po Europën

Presidenti "shpërthen" kundër ish-deputetit: Një njeri i tillë s' duhet të ishte bërë ministër

Presidenti Ilir Meta e quajti ish-ministrin Tahiri një delinkuent që "mbyti Europën me drogë". Nuk mund t'i shmangem të gjithë pyetjeve tuaja. Por ç'koment mund të kem unë për një delinkuent që mbyti me drogë jo vetëm Shqipërinë, por gjithë Europën", deklaroi z.Meta. Ai u shpreh se nuk do ta kishte bërë kurrë ministër të Brendshëm një person të tillë. Presidenti Ilir Meta...

Në faqen 5

34 EMRAT/ NE LISTE ISH-KRYETARI I SHISH DHE DY ISH-MINISTRA FINANCASH

CANI, ANGJELI DHE SHAQIRI, KUSH KANDIDON PER KLSH

Presidenca publikon emrat që janë ofruar për të drejtuar Kontrollin e Lartë të Shtetit. Kandidojnë edhe ish-kryetarja e KQZ-së, Leterije Luzi dhe Sali Shehu



(Në foto) Kandidatë për KLSH, Shkëlqim Cani, Anastas Angjeli dhe Bahri Shaqiri

ME SHUME LEKE PRONAREVE

Buxheti për çdo institucion, ja si do të ndahen 313 miliardë lekë

Në faqen 2

TIRANE

Hakeroi 3 mijë adresa në rrjetet sociale, policia prangos 20-vjeçarin

Në faqen 6

"BLUETOOTH"

Agoni i "Babastars" e ofendoi në këngë, përgjigjet menaxheri i Ledrit: Është i vogël

Suplement

INTERVISTA

Sindikata e arsimit, Alma Lama: Notat e nxënësve, jo më në regjistra personale

Në faqen 8

RREFIMI I VEÇANTE



Tedi Papavrami: Vështirësitë e ndarjes nga gruaja e parë pas 21 vitesh

Në faqen 11

Arsimi i lartë/ Rektori i universitetit dhe diplomatja shkëmbejnë dhurata

Bashkëpunimi, ambasadorja e Kinës viziton "Luarasin"

Jiang Yu: Pashë profesionalizëm. Et'hem Ruka: Thellim marrëdhëniesh

Nga VOLTIZA DURO
Në kuadër të bashkëpunimeve të vazhdueshme me institucionet e arsimit të lartë në shtete të tjera, Universiteti "Luarasi" ka pritur në një takim ambasadorën kineze në Republikën e Shqipërisë, Jiang Yu. Gjatë bashkë-



sedimit me stafin akademik të Luarasi-t dhe studentët, ambasadorja kineze ka theksuar se ndihet e nderuar që vizitonte këtë universitet, me qëllim forcimin e shkëmbimit arsimor dhe arritjen e marrëveshjeve bashkëpunuese. Më tej Yu ka vlerësuar...

Në faqen 9

BUXHETI I SHTETIT SHPËRNDARJA

17 mln \$ më shumë për pronat, përgjysmohet fondi për të përndjekurit

Buxheti për çdo institucion, si do shpërndahen 313 miliardë lekë

Sa përfiton Presidenca, Kryeministria dhe ministrinë

Vitin e ardhshëm do të kemi një numër më të madh ish-pronarësh që do kenë mundësi të marrin lekët e kompensimit. Qeveria ka paraqitur në Kuvend projektbuxhetin për vitin 2019, ku dhe parashikon një rritje të konsiderueshme të zërit për kompensimin e ish-pronarëve, kjo krahasuar me buxhetin e vitit 2018. Ndërsa për vitin ekzistues ajo buxhetoj afërsisht 33 milionë dollarë, për vitin e ardhshëm ka parashikuar një shifër që shkon për afërsisht 50 milionë dollarë. Kjo përbën edhe shumën më të madhe që ka vënë ndonjëherë ndonjë qeveri në dispozicion të kompensimit të ish-pronarëve dhe kjo nuk ka lidhje vetëm me faktin që vitin e ardhshëm është vit elektoral, por edhe me formulën e kompensimit që ka parashikuar qeveria me ndryshimet ligjore që miratoi para disa vitesh. Gjithsesi, kjo mbetet ende një shifër e ulët po të kemi parasysh faturën totale që kërkohet për të mbyllur përfundimisht çështjen e kompensimit të pronave, e cila llogaritet në afro 135 miliardë lekë të reja.

TË PËRNDJEKURIT

Por, ndërsa buxheti i vitit të ardhshëm paraqitet pozitiv për ish-pronarët, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për një tjetër shtresë të përvojatur në Shqipëri, ish-të përndjekurit politikë. Buxheti për këtë kategori është përgjysmuar. Nga rreth 2 miliardë lekë që qeveria akordoi një vit më parë në buxhetin e 2018, në vitin e ardhshëm ajo këtë shumë e ka përgjysmuar duke e çuar në vetëm 1 miliard lekë. Ky përbën në fakt edhe uljen më të madhe që ka pësuar ndonjë prej buxheteve të tjera për vitin 2019. Burime nga qeveria kanë bërë të ditur se kjo tkurrje vjen prej faktit se numri i personave që duhet të dëmshpërblehen për vuajtjet në burgjet e komunizëm ka rënë ndjeshëm, ndërsa mbetet ende në shu-



Ish-të përndjekur

ISH-TË PËRNDJEKURIT

Nga rreth 2 miliardë lekë që qeveria akordoi në buxhetin e 2018, vitin e ardhshëm ajo këtë shumë e ka përgjysmuar për ish-të përndjekurit politikë, duke e çuar në vetëm 1 miliard lekë.

RRITJA E PAGAVE REFLEKTOHET NË BUXHETIN E TRI MINISTRIVE

Përveç pronarëve, rritje ka pësuar edhe buxheti i disa ministrive, të cilat fushë veprimi të tyre kanë sektorë të tillë si shëndetësia, arsimit apo edhe ushtria. Bëhet fjalë për tre sektorë, për të cilët qeveria ka parashikuar rritje të pagave për vitin e ardhshëm. Rritje kjo që është reflektuar edhe në buxhetin e këtyre tri ministrive. Më konkretisht, buxheti i Ministrisë së Arsimit nga 38 miliardë lek shkon në 39 miliardë, duke përfshirë edhe faturën që duhet për të përballuar rritjen e pagave të mësuesve. Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë shkon nga 60 miliardë në afërsisht 61 miliardë lek dhe këtu përfshihet edhe fondi për përballimin e rritjes së pagave për infermierët dhe mjekët. Rritje në të njëjtat nivele ka pësuar edhe buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, i cili nga 19.7 miliardë që është këtë vit shkon në 21 miliardë për vitin e ardhshëm.

BUXHETI I SHTETIT, SI SHPËRNDARHEN PARATË PËR ÇDO INSTITUCION

Institucioni	Buxheti 2018	Buxheti 2019
Presidenca	247,500,000	248,000,000
Kryeministria	960,000,000	1,000,000,000
Kuvendi	1,193,200,000	1,148,160,000
Ministria e Bujqësisë	10,944,628,000	10,853,962,000
Ministria e Infrastrukturasë&Energjisë	47,542,630,000	46,904,204,000
Ministria e Financave	60,868,921,000	58,362,139,000
Ministria e Arsimit	38,374,242,000	39,167,143,000
Ministria e Kulturës	2,009,897,000	2,165,867,000
Ministria e Shëndetësisë	60,116,852,000	60,865,377,000
Të përndjekurit Politikë	2,051,300,000	1,047,300,000
Ministria e Drejtësisë	10,446,100,000	12,401,758,000
Pronat	3,412,500,000	4,899,080,000
Ministria e Jashtme	2,997,180,000	3,080,500,000
Ministria e Brendshme	21,110,038,000	20,925,355,000
Ministria e Mbrojtjes	19,797,838,000	21,002,417,000
SHISH	1,544,000,000	1,575,000,000
Ministria e Turizmit	2,258,760,000	2,626,840,000
Prokuroria e Përgjithëshme	1,679,000,000	1,750,000,000
Në total	309,298,980,000	313,106,567,000

micë trashëgimtarët e tyre. **INSTITUCIONET E TJERA**

Por ndërsa fondi për ish-të përndjekurit politikë është

të reduktuar në mënyrë të ndjeshme, qeveria nuk ka ngurrur që edhe për vitin e ardhshëm të rritë buxhetet e institucioneve të tjera

kryesore në vend, duke filluar që nga Presidenca, Kryeministria apo edhe ministrinë e ndryshme. Kështu, rritje ka pësuar



Gjatë një mbledhjeje të qeverisë

LARGIMI

Aleanca Kuqezi braktis koalicionin e Bashës: Të krijojmë polin e tretë

Aleanca Kuqezi pas një mbledhjeje të jashtëzakonshme vendosi dje largimin nga Koalicioni me Partinë Demokratike. Aleanca Kuqezi vendosi: "Largimin nga koalicioni me Partinë Demokratike. T'u bëjë thirrje të gjitha partive opozitare të largohen nga Partia Demokratike, e cila vazhdon marrëveshjen e tradhtisë së 17 majit Basha-Rama! T'i bëjë thirrje popullit për kryengritje popullore, si e vetmja mënyrë për shkatërrimin e establishmentit 30-vjeçar në politikë dhe eliminimin e dy bandave mafioze politike PD-PS. T'i kërkojë çdo deputeti të ndershëm të grisë mandatet dhe të largohen nga oligopoli PD-PS, që po shkatërronjë vetëqeverisjen për të shpëtuar nga burgu lideret e tyre politike". Gjithashtu, u bëhet thirrje partive të tjera opozitare të largohen edhe ato për të krijuar një pol të tretë. "Aleanca Kuqezi hap dyert dhe negociatat për krijimin e polit të tretë, si e vetmja alternativë qeverisëse, e cila mes rebelimit civil popullor do të kërkojë ndryshimin e sistemit elektoral, burgosjen e pushtetarëve të korruptuar, vendosjen e shtetit ligjor dhe themelimin e një qeverie të re patriotike dhe pushteti nacionalist modern evropian", - thuhet në njoftimin e AK, e cila drejtohet nga Lumtur Ratoçeri.



buxheti i institucionit të Presidentit, i cili nga 247 milionë lekë ka kaluar në 248 milionë lekë. Megjithatë bëhet fjalë për një rritje fare të vogël, tregon qartë që qeveria kërkon ta mbajë mirë me institucionin e presidentit. Por, qeveria ka rritur edhe buxhetin e Kryeministrisë nga 960 milionë në 1 miliard lekë. Rritje kanë pësuar edhe një sërë

institucioneve të tjera si Ministria e Jashtme, Ministria e Drejtësisë apo edhe Prokuroria. Por nuk ndodh e njëjta gjë me Ministrinë e Bujqësisë, e cila ndonjëherë mbulon ndoshta pjesën më të rëndësishme të ekonomisë së vendit, ka pësuar ulje. Nga 11 miliardë lekë në 2018 në vitin e ardhshëm buxheti i kësaj ministrie shkon në 10.5 miliardë.



Qeveria dorëzon në Kuvend draftin, zbardhet projektligji i ri për dëshmorët

Nisma, qeveria shpall "Dëshmorë të Atdheut" viktimat e 21 janarit

Nuk preken statutet e dhëna gjatë diktaturës

Për socialistët vrasjet gjatë protestës së 21 janarit 2011 para Kryeministrit ishin një krim i pastër shtetëror, ndaj dhe 4 viktimat e këtij krimi duhen nderuar si dëshmorë që ranë për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ndaj për këtë qëllim, qeveria socialiste ka paraqitur në Kuvend një projektligj të ri "Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut", me anë të cilit përcakton ndër të tjera që këtë status mund ta marrin të gjithë "shtetasit shqiptarë të vrarë gjatë tubimeve paqësore dhe pa armë për respektimin e të drejtave dhe liritë themelore të njeriut si dhe ata që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor, pas datës 8 dhjetor 1990". Një përcaktim që bën të mundur që statusin e "Dëshmorit të Atdheut" ta marrin edhe 4 të vrarët në protestën e 21 janarit të thirrur nga Partia Socialiste dhe konkretisht: Ziver Veizi, Faik Myrtaj, Hekuran Deda dhe Aleks Nika. Nëpërmjet kësaj dispozite qeveria jo vetëm që vlerëson 4 viktimat, por edhe një krim të qeverisë së atëherëshme vrasjen e tyre. Kjo nisimë u jep mundësi, gjithashtu, familjeve të Dëshmorëve të Atdheut të gëzojnë nderim e përkrahje të veçantë nga shteti.

FAMILJARËT

Sipas projektligjit në fjalë ato përfitojnë shpërblim financiar mujor, kriteret dhe masa e të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes. Ndërkohë që në rrethin e familjarëve, për efekt shpërblimi, sipas këtij projektligji, bëjnë pjesë bashkëshortja, fëmijët nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues. Në vazhdimësi socialistët kanë akuzuar ish-kryeministrin Sali Berisha dhe ministrin e Brendshëm për vrasjet e asaj dite, ndërsa që nga koha që kanë qenë në opozitë kanë premtuar se do të bëjnë drejtësi për ta. Por kur kanë kaluar 5 vite nga marrja e pushtetit, socialistët kanë mundur vetëm që t'i japin ndihmë ekonomike familjarëve të 4 viktimave të 21 janarit, por pa mundur që të bëjnë drejtësinë e premtuar.



Kryeministri Edi Rama duke përkujtuar viktimat e 21-janarit

KATEGORITË

Projektligji parashikon që statusi i "Dëshmorit të Atdheut" u njihet edhe të gjithë personave, të cilët kanë humbur jetën për lirinë, pavarësinë kombëtare dhe mbrojtjen e territoreve shqiptare apo në përpjekje për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe para datës 28 nëntor 1912, shtetasit shqiptarë, të cilët kanë marrë pjesë me armë në dorë ose në formë të organizuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë e bashkëpunëtorëve të tyre, nga data 7 prill 1939 deri

kundërshtimit të pushtimit të trojeve shqiptare nga ushtritë e huaja dhe të qëllimeve shoviniste të tyre, nga data 28 nëntor 1912 deri më 7 prill 1939. Gjithashtu, këtë status e marrin sipas këtij projektligji edhe shtetasit shqiptarë, të cilët kanë marrë pjesë me armë në dorë ose në formë të organizuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë e bashkëpunëtorëve të tyre, nga data 7 prill 1939 deri

më 9 maj 1945. Nga ky ligj përfitojnë edhe personat që kanë rënë gjatë luftës për gliminin e Kosovës. Projektligji lë në fuqi të gjitha vendimet e mëparshme për shpalljen "Dëshmor", përfshi këtu edhe gjatë sistemit të mëparshëm. Përfshihen nga kjo e drejtë vetëm ata që janë dënuar me vendim të formës së prerë për krime kundër njerëzimit, bashkëpunim me pushtuesit dhe veprimtari terroriste e agjenturore kundër Shqipërisë.

"Rezolutë për zgjedhjet dhe marrëdhëniet me Greqinë"

Vjedhja e votës, Kokëdhima thirrje ndërkombëtarëve: Ndërhyjni

Mbi 30 parti politike, lshoqata të shoqërisë civile dhe individë u mblodhën dje në Tiranë për të kërkuar zgjedhje të lira dhe të barabarta. Tryezës u bashkua edhe ish-presidenti i Republikës, Bujar Nishani. Bashkëkryetari i tryezës, kryetari i partisë "Zgjidhja", Koço Kokëdhima, ritheksoi domosdoshmërinë e reformës zgjedhore, të vërtetë dhe jo si farsë e PS dhe PD. Tryeza miratoi dy rezoluta, një për zgjedhjet e lira dhe një për marrëdhëniet Shqipëri-Greqi. Partitë e vogla kanë kërkuar rritjen e presionit të ndërkombëtarëve ndaj PD-së dhe PS-së për finalizimin e reformës zgjedhore. Kokëdhima akuzoi ashpër dy partitë e mëdha duke theksuar se



atyre u intereson të mos bëjnë ndryshime, pasi sipas tij vjedhin dhe cenojnë në vazhdimësi proceset. "PS dhe PD janë një, janë nofulla të së njëjtës gojë. Të asaj goje që kafshon pa mëshirë interesat dhe gjakun e popullit shqiptar", deklaroi z.Kokëdhima.

Ai shprehu pakënaqësi dhe për prezencën e OSBE-së. "Nuk është besnike e rekomandimeve të saj", u shpreh z.Kokëdhima. Në tryezën e partive të vogla i ftuar ishte edhe ish-presidenti Bujar Nishani, i cili u kërkoj atyre që të rrisin presionin ndaj partive të mëdha. Nishani teksa bëri thirrje për ashpërim të dënimeve për krimet elektorale, atakoi ashpër reformën territoriale. "Qeveria shqiptare zyrtarisht pranon se shpenzimet janë të njëjta pak më tepër. Ndaj ky është një argument që e asgjëson një nga elementet kryesore të agresionit që u bë perceptimit dhe trurit të shqiptarëve, për të pranuar një reformë të e besuan që nuk ishte tillë", theksoi z.Nishani.

PROJEKTIGJI PËR STATUSIN "DËSHMORIT TË ATDHEUT"

■ NENI 5

Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit "Dëshmor i Atdheut" Dëshmorë të Atdheut shpallen ose u njihet statusi, si të tillë.:

Personat, të cilët kanë humbur jetën për lirinë, pavarësinë kombëtare dhe mbrojtjen e territoreve shqiptare apo në përpjekje për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe para datës 28 nëntor 1912; Shtetasit shqiptarë e të huaj, të cilët kanë rënë në luftë për mbrojtjen e integritetit territorial, të lirisë e pavarësisë së Shqipërisë, si dhe për arsye të kundërshtimit të pushtimit të trojeve shqiptare nga ushtritë e huaja dhe të qëllimeve shoviniste të tyre, nga data 28 nëntor 1912 deri më 7 prill 1939;

Shtetasit shqiptarë, të cilët kanë marrë pjesë me armë në dorë ose në formë të organizuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë e bashkëpunëtorëve të tyre, nga data 7 prill 1939 deri më 9 maj 1945;

Shtetasit shqiptarë të vrarë gjatë tubimeve paqësore dhe pa armë për respektimin e të drejtave dhe liritë themelore të njeriut si dhe ata që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor, pas datës 8 dhjetor 1990;

Shtetasit e huaj, pjesëtarë të formacioneve të ushtrive aleate në Luftën e Dytë Botërore, në ndihmë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, të cilët kanë humbur jetën brenda territorit të Shqipërisë;

h) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë rënë duke luftuar për pavarësinë e Kosovës, si dhe shtetasit shqiptarë të rënë për të drejtat kombëtare në konfliktet e tjera etnike të zhvilluara në Ballkan.

■ NENI 6

Përfshajtimi nga statusi "Dëshmor i Atdheut" Statusin "Dëshmor i Atdheut" nuk e përfitojnë personat, të cilët janë dënuar me vendime gjyqate të formës së prerë për:

1. krime kundër njerëzimit;
2. bashkëpunim me pushtuesit e vendit;
3. veprimtari terroriste dhe agjenturore kundër interesave të Shqipërisë;
4. vrasje me dashje, pas datës 9 maj 1945.

■ NENI 7

Dëshmorët e shpallur me vendime të organeve shtetërore të mëparshme Të gjitha dekretet/vendimet e organeve shtetërore për shpalljen "Dëshmor", të marra para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk janë objekt rishikimi nga ky ligj.

MANDATI EMRAT

Gjyqtarë dhe ish-deputetë, Presidenca publikon listën zyrtare me 34 emra

Kandidatët për kreun e KLSH-së, nga Cani e Angjeli deri te Shaqiri

Në garë, edhe ish-kryetarja e KQZ-së

Valentina Madani

Presidenca publikoi dje listën me emrat e kandidatëve që kanë aplikuar për pozicionin kushtetues të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Institucioni i Presidentit ka zyrtarizuar listën me 34 kandidatë për pozicionin kushtetues të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. 34 kandidatë garojnë për postin e kreut të ri të KLSH-së. Në listë ka shumë figura të njohura, mes tyre deputeti aktual i PS, Anastas Angjeli, i cili ka mbajtur disa funksione të larta shtetërore, zvmministër i Financave, ministër i Çështjeve Sociale dhe ministër i Ekonomisë në qeveritë e drejtuara nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Gjithashtu, në listë janë edhe ish-ministri i Financave, Shkëlqim Cani, Sali Shehu, ish-kryetarja e KQZ-së, Lefterie Luzi (Lleshi) por edhe shumë emra të tjerë. Ish-kreu i SH-ISH, Bahri Shaqiri, i cili është këshilltari i presidentit Ilir Meta për sigurinë. Pas lënies së detyrës në krye të SHISH-it, Shaqiri ka mbajtur postin e zvmministrit të Infrastrukturrës në qeverinë "Rama-Meta". Mes emrave të publikuar nga Institucioni i Presidencës është edhe ish-deputetja e Partisë Demokratike, Liljana Elmazi; ish-deputeti i jetër i PD-së, zyrtari aktual i FRD-së Sali Shehu dhe ish-deputeti ballist, Alfred Çako apo emra të njohur nga fusha e Drejtësisë, si Vitore Tusha e Petrit Fusha. Në garë është edhe ish-kreu i Shërbimit Institucionali i Presidentit të Republikës, njofton se pas përfundimit të afatit të aplikimit, rezultoi se kanë shprehur interesin për t'u përzgjedhur si kandidat për pozicionin kushtetues të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, 34 aplikantë. Presidenca bën me dije se kandidati që do t'i propozohet Kuvendit të Shqipërisë për t'u zgjedhur në pozicionin kushtetues të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i përzgjedhur në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin e brendshëm, do të publikohet brenda afatave ligjore. "Pas kësaj faze Institucioni i Presidentit të Republikës bën me dije se kandidati që do t'i propozohet Kuvendit të Shqipërisë për t'u zgjedhur në pozicionin kushtetues të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i përzgjedhur në përputhje me Kushtetutën dhe


legjislacionin e brendshëm, do të publikohet brenda afatave ligjore", sqarohet në njoftimin të Presidencës. Lista me emrat që ndodhet në Presidencë pritet që të kalojë

në komisionet parlamentare dhe më pas në Kuvend për votim për të mësuar emrin e pasuesit të Bujar Leskaj. KLSH-ja është institucioni më i lartë i kontrollit

ekonomik e financiar për fondet publike. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka mandat 7-veçar që votohet në Kuvend. Aktualisht detyrën e kreut të Kontrollit të Lartë të Shtetit e mban Bujar Leskaj, të cilit i mbaron mandati brenda dhjetorit të 2018-ës. Pak kohë më parë Leskaj bëri të ditur se nuk do të rikandidojë dhe për këtë arsye vuri në dijeni Presidentin Meta dhe kreun e Kuvendit Gramoz Ruçi.

TË GJITHË KANDIDATËT PËR POSTIN E KRYETARIT TË RI TË KLSH-SË

1. Agron Agalliu U.T, Fakulteti i Ekonomisë, ekonomist.
2. Anastas Angjeli, U.T, Fakulteti i Ekonomisë, financier "Akademik" "Profesor" "Doktor"
3. Albana Dhimitri U.T, Fakulteti i Ekonomisë financier-kontabilist, "Doktor",
4. Alba Qirjazi U.T, Fakulteti i Ekonomisë, financier-kontabilist.
5. Aelita Mani (Shprehja e interesit dërguar me rrugë postare administruar dt. 01.11.2018) U.T, Fakulteti i Ekonomisë, merceolog i përgjithshëm "Doktor".
6. Alfred Çako U.T, Fakulteti Gjeologji Miniera, inxhinier minierash.
7. Bahri Shaqiri U.T, Fakulteti i Drejtësisë, jurist.
8. Bajram Lamaj Inst.Lartë Bujqësor, Fak.Ekonomi Agrare, financier. U."Kristal", F. i Drejtësisë, jurist.
9. Bajram Muçaj, Inst.Lartë Bujqësor, Fak.Ekonomi Agrare, ekonomist. "Prof. i Asociuar" "Doktor i Shkencave".
10. Behar Zeneli U.T, Fakulteti i Drejtësisë, jurist.
11. Bujar Stafuka U.T, Fakulteti i Ekonomisë, ekonomist.
12. Edmond Verçani U.T, Fakulteti i Ekonomisë, ekonomist.
13. Eduart Ypi U.T, Fakulteti i Ekonomisë, financier-kontabilist.
14. Eridian Saliqani U.T, Fakulteti i Drejtësisë, jurist.
15. Ermal Yzeiraj U.T, Fakulteti i Drejtësisë, jurist.
16. Gjergji Dhima U.Bujq. Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë, ekonomist.
17. Hysen Muceku (Shprehja e interesit dërguar me rrugë postare administruar dt. 31.10.2018) U.Bujq.Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë, ekonomist, "Prof. i Asociuar" "Doktor".
18. Kestrin Katro U.T, Fakulteti i Drejtësisë, jurist, "Profesor", "Doktor".
19. Lefterie Luzi (Lleshi) U.T, Fakulteti i Drejtësisë, jurist.
20. Liljana Elmazi (Billa) U.T, Fakulteti i Ekonomisë, ekonomist, "Profesor", "Doktor".
21. Lumtor Shkreli U.Parmës-Itali, Fakulteti i Ekonomisë, ekonomist.
22. Muhamed Kavaja U.T, Fakulteti i Drejtësisë, jurist.
23. Petrit Bushi U.T, Fakulteti i Ekonomisë, financier-ekonomist. U.T, Fakulteti i Drejtësisë, jurist, "Doktor".
24. Petrit Fusha U.T, Fakulteti i Drejtësisë, jurist U.T, Fakulteti i Ekonomisë, ekonomist.
25. Pëllumb Ibrahim.
26. Qerim Lazaj U.T, Fakulteti i Ekonomisë, ekonomist.
27. Rushan Nano U.T, Fakulteti i Ekonomisë, ekonomist.
28. Sabri Hoxha U.T, Fakulteti i Mjekësisë, mjek i përgjithshëm, U.Politeknik.T, F.Gjeologji Miniera, inxhinier gjeolog, "Doktor".
29. Sali Shehu U. "Luigj Gurakuqi" Shkodër, F.Drejtësisë, jurist. Sh.Lartë e Min.Brendshme, oficer i Policisë Kriminale, "Doktor".
30. Shkëlqim Cani U.T, Fakulteti i Ekonomisë, financier, "Profesor", "Doktor".
31. Shpëtim Ahmetaj U.T, Fakulteti i Ekonomisë, financier
32. Vitore Tusha U.T, F.Shkencave Politiko Juridike, jurist, "Doktor".
33. Ylber Karanxa U.Bujq. Tiranë, Fakulteti i Bujqësisë, ekonomist agrar, "Doktor".
34. Zaim Korsi Inst. i Lartë Bujqësor, F.Ekonomi Agrare, ekonomist kontabël, "Doktor".



Presidenti Ilir Meta
gajtë pritjes së
djesme me gazetarët

KANDIDATËT

34 kandidatë garojnë për postin e kreut të ri të KLSH-së. Në listë ka shumë figura të njohura, mes tyre deputeti aktual i PS, Anastas Angjeli; ish-kryetarja e KQZ, Lefterie Lleshi; ish-ministri i Financave, Shkëlqim Cani dhe Bahri Shaqiri, ish-kreu i Shërbimit Informativ Shtetëror, aktualisht këshilltar për çështjet e sigurisë i Presidentit Ilir Meta.



"Qeveria 'Rama' funksionon si mafia"

Tabaku: Prej korrupsionit
investitorët nuk vijnë në Shqipëri

Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, shprehu dje shqetësimin se, "rendimenti të fundit në rajon në oportunitetet që u japim bizneseve të hapen". "Vazhdojmë të jemi armiqësorë ndaj investimeve të huaja duke i larguar ato përditë e më shumë. Të parafundit në rajon për biznes dhe të parët në rajon për kriminalitetin dhe inkriminimin e qeverisë. Kjo është pasaporta me të cilën Shqipëria prezantohet nga kjo qeveri në rajon dhe në gjerë. Më poshtë se Maqedonia, më poshtë se sa Serbia, më poshtë se Mali i Zi dhe në betejë të etshme me Bosnje Hercegovinën", shkruan Tabaku. Deputetja demokrate shton: "Të parët në rajon për taksat që paguajmë dhe të fundit në rajon për mbledhjen dhe mirëmanaxhimin e tyre. Një biznes paguan 33.7% të fitimeve të tij si taksa duke paguar më shumë se një biznes në Maqedoni. Mal të zi apo edhe Serbi. Mbi 45 biznese në ditë mbyllet, të tjerë punojnë në informalitet për të mbajtur familjet me bukë. Një biznes me 100 mijë lekë fitim në vit do t'i duhet të paguajë 37,300 lekë taksa nga ky fitim që shkojnë jo për rrugë, jo për shkollë, jo për spitale po për tenderime e koncesione abuzive". "Më shumë taksa, më pak të ardhura, më shumë korrupsion, më shumë informalitet, më shumë krim dhe një qeveri që funksionon si mafia. Koha e Ramës ka mbaruar! Largimi i kimit nga politika dhe taksa e sheshtë mund ta bëjnë përsëri Shqipërinë konkurruese në rajon", mbyllet postimi i Tabakut.

TABAKU

Deputetja demokrate: Të parët në rajon për taksat që paguajmë dhe të fundit në rajon për mbledhjen dhe mirëmanaxhimin e tyre.

Vangjush Dako paralajmëron padi ndaj Berishës, PD: E ke vendin në burg

PD-ja përmes deputetit Flamur Noka akuzoi dje kreun e Bashkisë Durrës, Vangjush Dakon se ka bashkëpunuar me bandat e Durrësit duke i përdorur ato për të blerë vota për pushtetin e tij dhe të Edi Ramës. Sipas Nokës, për këtë krim ai duhet të jetë në burg! "Faktet e krimit elektoral të Vangjush Dakos janë të qarta. Përgjimet në dosjen 330 janë të plota dhe provojnë lidhjen e tij me bandën e Avdyllajve, disa prej të cilëve janë në burg për trafik droge, si pjesë e të njëjtës dosje hetimore. Dako dështoi të mashtronte shqiptarët se nuk e dinte aktivitetin kriminal të Avdyllajve dhe se i ka takuar ata vetëm në zgjedhje, si të gjithë qytetarët e Durrësit, duke mos u bërë asnjë favor", deklaroi z.Dako. Por Vangjush Dako në rrjetet sociale injoroi deklaratën e PD-së dhe paralajmëroi padi vetëm për Sali Berishën, i cili ka thënë se një ambasador shumë i rëndësishëm në vendin tonë i ka pohuar se kryebashkiaku i Durrësit do të arrestohet. Sipas, Dakos ish-kryeministri shpif, pasi nuk ka ambasador që shkon e flet për arrestime tek një politikan. Pa ia kursyer ironinë, Dako shprehet i habitur që edhe ai flet përditë me qytetarët për arrestimin e Berishës, por ai është ende i lirë.



Ikja e Xhafajt, presidenti: S'ka vend për investigime, për Lleshin vendimi do të jetë shumë kurajoz

Meta: Tahiri, delinkuent që mbyti Shqipërinë dhe Europën me drogë

"S'do e bëja kurrë ministër një person të tillë"

Presidenti Ilir Meta e quajti ish-ministrit Tahiri një delinkuent që "mbyti Europën me drogë". Nuk mund t'i shmangem të gjithë pyetjeve tuaja. Por ç'koment mund të kem unë për një delinkuent që mbyti me drogë jo vetëm Shqipërinë, por gjithë Europën, deklaroi z.Meta. Ai u shpreh se nuk do ta kishte bërë kurrë ministër të Brendshëm një person të tillë. Presidenti Ilir Meta i ftuar mbrëmë në studion e SYRI.net në emisionin "FAKT" deklaroi se do të marrë kohën e duhur për të dekretruar ose jo. Sandër Lleshin në postin e ministrit të Brendshëm.



Presidenti Ilir Meta dje në emisionin "FAKT"

Unë jam për të ushtruar përgjegjësitë e mia në raport me opinionin dhe Kuvendin, pastaj secili bën vlerësimin e tij. Në radhë të parë aty ka shumë emra që mund të ishin në krye të këtij institucioni unë do të gjykoj duke parë me shumë vëmendje emrat e kësaj liste në rrethanat aktuale.

Jeni takuar me Tom Doshin në Firence ku ishte i ftuar në ditëlindjen e Kardinalit shqiptar?

Së pari jam ndier shumë mirë 24 orë në Firence për shkak të vlerësimit të jashtëzakonshëm që i është bërë Kardinalit tonë nga vetë Kardinali i Firences dhe kryetari i bashkisë, por dhe nga mesazhi që veçantë që ishte zgjedhur për të vlerësuar kardinalin tonë, por në mënyrë të veçantë edhe nga mesazhi i papa Françeskut për kardinalin tonë. Zoti Tom Doshi ka qenë i ftuar, sepse është njeri i afërt i Kardinalit Troshani, unë kam qenë i ftuar edhe nga Kardinali i Firences të cilin unë e kisha ftuar të vinte në Shqipëri, -tha Presidenti Ilir Meta. Zoti Peka, shiko përpara. Ishim për ditëlindje ishëm për një festë për mesazhe pozitive.

Kur jeni takuar për herë të fundit me kryeministrin Rama?

Jemi takuar dhe takohemi sa herë na jepet mundësia. Do të përiqem ta verifikoj që të jem i saktë, sepse pastaj ju të kritikoni fort. Fakti që nuk po jap një përgjigje të saktë është se kjo nuk është shumë e rëndësishme, unë mesazhet e mia i jap vazhdimisht, komunikoj me letra me shkresa. Unë takohem me të gjithë ata që më lidh puna për shkak të funksionit apo me të gjithë ata që duan të më takojnë.

Cili është koment i juaj për ngjarjen e Bularatit?

Është një ngjarje, e cila synon të krijojë një acarim artificial të marrëdhënieve shqiptare greke, që nuk është hera e parë që ndodh. Sigurisht që ka probleme, por ka përpjekje për t'i amplifikuar ato, sepse interesat e bashkëpunimit janë më të mëdha. Unë kam bërë një qëndrim timin në publik. Shoh që ka zëra mjaft të arsyesueshëm, siç është ish-ministri i Jashtëm grek, apo ministrja greke e Kulturës. Unë mendoj se minoriteti grek në Shqipëri i ka të gjitha të drejtat. Është mjaft i integruar është një pasuri e madhe për vendin tonë. Natyrisht që ka dhe njerëz që janë të helmuar nga propaganda, natyrisht që ne nuk duhet të biem për e kësaj propagande, por duhet të tregojmë vullnetin tonë për të forcur marrëdhëniet.

Basha: Xhafaj iku pasi humbi luftën e bandave me Dakon dhe Tahirin

Kreu i opozitës deklaroi mbrëmë nga emisioni "Zonë e Lirë" se largimi i Fatmir Xhafajt erdhi pas përplasjes me bandën e Vangjush Dakos. Ai tha se Xhafaj ra pas përplasjes së bandave politike me njëra-tjetër. Në thelb kjo është përplasja bandash politike. Në një krah bandat e Tahirit dhe Gjushit u përplasën me bandën e Xhafajt. Kjo ishte përplasja bandash për pushtet. Rama mbrojti Dakon. Sot kemi një kryebashkiak, siç është Dako, që është kapur nga përgjimet duke bashkëpunuar me bandat dhe akoma është i lirë. Të gjithë e dinë se çfarë bën dakon në Durrës, ai është shumë i rëndësishëm për Dakon. Përpjekja për të mbrojtur Dakon e ka çuar të kërcënojë Xhafajn me një tjetër dosje. I pyetur se çfarë mendimi ka për Sandër Lleshin i propozuar për postin e ministrit të Brendshëm, Basha tha se ai është këshilltar i Ramës. E para e punës PD nuk është autoritet dosjesh, nuk mund të flas nëse ka dosje apo jo. Ky personazh prej 5 vitesh është këshilltar i Edi Ramës. Kabineti përbëhet nga ministrat, të cilët vijjnë bashkë me kryeministrin si pjesë e një vizioni. Ky kandidat për ministër të brendshëm bën përjashtim, dy persona vinin nga politika, Saimir Tahiri, i cili u larguar nga politika ku akuzohet si bashkëpunëtor i Habilaive, i dyti u largua për një tjerët skandal se kishte vëllain trafikant dhe ku u kap gafil, i treti është thjeshtë një varfëri i Ramës. Ai shkon atje si zvmnistër i Brendshëm se kreu i saj është vetë Edi Rama, -tha z.Basha.



Z.President si e shikoni dorëheqjen e ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj?

S'ka vend për t'u bërë investigime, apo për të hyrë në diskutime të rrethanave të tjera, e ka gjykuar këtë gjë që kështu është më mirë dhe ky vullnet është respektuar.

Do ta dekretroni Sandër Lleshin për ministër të Brendshëm?

Do gjë kohën e duhur, për të marrë vendimin e duhur. Presidenti ka për detyrë për të ushtruar të gjitha detyrimet kushtetuese për çdo propozim që i bëhet. Nuk mund të hedh firmë për dekrete formale e aq më tepër për një detyrë të tillë që në momentin aktual kërkon përgjegjshmëri. Di të marr vendimet e mia, pa u ndikuar nga askush, as nga orët dhe sekondata. Kushtetuta është shumë e qartë, presidenti ka përgjegjësi për çdo firmë që hedh. Nëse do të kishte firmë unë atë nuk do ta lija për ta shpallur në studion tënde, do ta kisha bërë atë publike. Vendimi do të jetë shumë kurajoz. Nuk është çështje shtatullash, por është çështje bindjes, nëse nuk më bindin nuk do t'i dekretoj. Kemi rastin e Italisë ku presidenti ka të njëjtat kompetenca, ku ai mendoi se një emër i propozuar si ministër ekonomie nuk e firmosi, pasi mendoi se rrezikonte ekonominë e Italisë. Askush nuk e detyron presidentit të firmosë një emër jashtë bindjes së tij. Në këtë drejtim unë përgjegjshmëritë e mia do t'i ushtrroj në mënyrë kurajoz

dhe maksimale. Në këto momente Shqipëria është në luftë me krimin e organizuar, dhe kjo po e mban Shqipërinë larg BE-së. Unë nuk paragjykoj askënd unë ushtror përgjegjësitë e mia në mënyrë maksimale. Të gjithë ata që mendojnë se mund të ndikojnë në mënyra të ndryshme sipas interesit apo vlerësimit të tyre, duhet të jetë të qetë se unë nuk ndikohem nga asgjë, përveç detyrës që i takon presidentit për të qenë një institucion i përgjegjshëm.

Po për çështjen "Tahiri"...

Nuk mund t'i shmangem të gjithë pyetjeve tuaja. Por ç'koment mund të kem unë për një delinkuent që mbyti me drogë jo vetëm Shqipërinë, por gjithë Europën. Një nga përgjegjësitë e mia është që një person i tillë nuk duhet

sepse ajo i jepet presidentit dhe jo kryeministri. Ai nuk meritonte të sillte një dekret tjetër në presidencë, unë e konfirmova, sepse i kisha vënë kusht që të vazhdohte luftën me drogën dhe krimin. Unë kam qenë dëshmitar në mbledhje të sigurisë kombëtare. Unë duke të njohur ty, ti di që po ta kishte bërë ty, ti as dekretim për ta bërë ambasador e as dekoratë nuk do i jepje. Unë i kam dhënë dekoratë, sepse ka mbajtur qëndrim shumë të qarta sa i vlen luftës kundër drogës dhe krimin. SHISH ka punuar më mirë se shumë institucione të tjera në këtë fushë.

Presidencia publikoi listën me 34 kandidatë për postin e kreut të ri të KLSH-së. Jeni njohur me të gjithë emrat?

Jam njohur me listën dhe

APELI

Presidenti i Republikës Ilir Meta, ftoi dje në një pritje përfaqësuesit e medias dhe ambasadorët e akredituar në Tiranë, në kuadër të ditës ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara të mbrojtjes së gazetarëve. Meta dënoi të gjitha rastet e dhunës dhe kërcënimet që u janë bërë gazetarëve shqiptarë.

të ishte bërë kurrë ministër i Brendshëm dhe unë e kisha të gjithë mundësinë. Por me këmbënguljen e kryeministrit ai u bë ministër i Brendshëm.

Përse nuk e keni dekretruar ende kreun e ri të SH-ISH?

Nuk mendoj se është vendi këtu për të bërë diskutime të tilla. Unë vendos me bindje të plotë. Në rastin aktual as s'e kam kthyer e as s'e kam konfirmuar. Shumë të mirë e kemi marrëdhënien me zv.drejtorin aktual të SHISH. Rrethanat se si u bë dorëheqja e zotit Ajazi, e cila ka qenë një dorëheqje jokorrekte,

me dy tre emra, të cilët janë shprehur para 30 tetorit. Përdërisa kam ndjekur një rrugë të tillë që në mënyrë publike secili të aplikojë, dhe dua t'i falënderoj ata që kanë aplikuar, sigurisht që nuk kish të kuptim, sepse aty ka mjaft emra të spikatur dhe gjysma e tyre janë akademikë, dhe sigurisht emri do të dalë nga kjo listë. Unë kam respekt për të gjithë emrat dhe ky është një proces që do kohën e vet. Ky është një raport mes presidentit dhe Kuvendit. Presidenti bën propozimin për drejtimin e këtij institucioni, Kuvendi ka të drejtën e aprovimit ose mos aprovim

Berisha publikon shifrat: 72.873 biznese kanë falimentuar që prej 2014

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje me shifra falimentimin e bizneseve në Shqipëri nga viti 2014. "Klimë vrastare për bizneset në Shqipëri! Nga 1 janari i vitit 2014 deri sot falimentuan: 72873 biznese dhe mbeten pa punë rreth, 120.000 të punësuar. Gjatë periudhës janar - tetor 2018 kanë kaluar në status pasiv plot 13.015 biznese, ose 65 % më shumë sesa e njëjta periudhë e vitit të kaluar (gjatë të cilës kaluan në status pasiv 7.878 biznese). Gjatë muajit tetor 2018 kanë kaluar në status pasiv plot 1.788 biznese, ose 85 % më shumë sesa tetor 2017 (gjatë të cilës kaluan në status pasiv 967 biznese). Gjatë periudhës janar - tetor 2018 kanë kaluar në status pasiv plot 13.015 biznese, ose 65 % më shumë sesa e njëjta periudhë e vitit të kaluar (gjatë të cilës kaluan në status pasiv 7.878 biznese). Që nga 1 janar 2014 e deri më sot kanë kaluar në status pasiv (kanë ulur qepenat) plot 72.873 biznese", shprehet z.Berisha.

Shkak, parakalimi i gabuar e shpejtësia

Aksident në Rugën e Kombit, 2 të vdekur dhe 3 të plagosur

MIRDITË - Një aksident tragjik ka ndodhur pasditen e djeshme në Rugën e Kombit, pranë fshatit Fang në Rubik. Burime nga policia lokale bënë me dije se nga përplasia e dy mjeteve kanë humbur jetën dy persona, ndërsa janë plagosur rëndë tre të tjerë. Mësohet se rreth orës 15:00, një automjet tip "Benz" me targa AA182TY që po lëvizte drejt Kukësit është përplasur me automjetin "Volswagen" me tar-

ga AA943NP që po shkonte nga Puka në Tiranë dhe me vete kishte edhe dru zjarri. Përplasia ka qenë fatale për drejtuesit e këtyre makinave, të cilët kanë mbetur të vdekur në vend. Bëhet fjalë për 63-vjeçarën Jak Sylja nga Fushë-Arrëzi dhe 52-vjeçarën Myftar Kovaci nga Hasi. Ndërkaq, kanë mbetur të plagosur 3 shtetas të mjetit tip "Benz". Sipas bluve, të plagosurat N.K. dhe F.K. u transportuan në Spitalin e Traumës në Tiranë me he-



liopter, ndërsa shtetasja L.D. u transportua po në këtë spital me ambulancë. Menjëherë, grupi hetimor ka shkuar në vendngjarje ku ka kryer hetimet për zbardhjen e plotë të shkaqeve të aksidentit. Paraprakisht dyshohet se shkak për aksidentin është bërë një parakalimi i gabuar dhe shpejtësia tej normave të lejuara.

Zaganjori: Nuk kam konflikte me askënd

Gjoha për parkimin, zbuloi tritolin në makinën e tatimorit

SHKODËR - Shpërthimi me eksploziv në makinën e punonjësit të Tatimeve në Shkodër, Nehat Zaganjori ka alarmuar policinë. Mësohet se pas ngjarjes së ndodhur mbremjen e së enjtes në qytetin verior grupi anti-eksploziv mbërriti nga Tirana. Nga ekspertiza rezultoi se ishte një sasi tritolini prej rreth 20-30 gr me magnet. Sipas bluve, lënda plasëse ishte ngjitur tek targa e makinës (në pjesën mbra) teksa mjeti i ins-

pektorit ndodhej i parkuar para një lokali në afërsi të banesës së tij. Patrulla e policisë i ka vendosur një gjobë mjetit në fjalë, pasi kishte parkuar në kundërvajtje. Një i njohur i inspektorit ka dalë për të parë gjobën kur ka konstatuar në mjet lëndën plasëse. Menjëherë ai ka njoftuar Zaganjorin, duke qenë se e njëjta. Ky i fundit bashkë me shokët e tij e kanë goditur me këmbë lëndën plasëse duke e hedhur në tokë, ndërsa nuk ka shpërthyer. Më pas është



njoftuar policia. Sipas bluve, makina nuk kishte më shumë se 45 minuta e parkuar në vendin e quajtur "Ura Dervishbeg", ndërsa tritolini është vënë rreth orës 19:30. Ndërkaq, Nehat Zaganjori ka deklaruar se nuk ka konflikte me askënd dhe se e vetmja arsye e vendosjes së tritolini në mjetin e tij mund të jetë për shkak të detyrës.

I riu me origjinë nga Peqini e nisi aktivitetin që 12 vjeç, u kap pas 6 muaj hetimesh

TIRANË

Një 20-vjeçar është arrestuar nga policia e Tiranës, pasi dyshohet se ka ndërhyrë në mbi 3000 adresa të rrjeteve sociale, të cilat kanë qenë të shtetasve shqiptarë dhe të huaj. Mësohet se Arben Bozhiqi, lindur në fshatin Pajovë të Peqinit dhe banues në Laprakë që në moshën 12-vjeçare ishte specialist kompjuterësh dhe vidhte të dhëna duke hakuar profile të ndryshme në rrjetet sociale dhe adresa e-maili. Ai u kap pas 6 muajsh hetime, ndërsa akuzohet për veprat penale: "Ndërhyrja në të dhëna kompjuterike", "Falsifikimi kompjuterik" dhe "Hyryje e paautorizuar kompjuterike". Arrestimi i të riut u bë nga Sektori për Hetimin e Krimeve Kompjuterike në Departamentin e Policisë Kriminale, në Policinë e Shtetit në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjatë kontrollit të banesës dhe kontrollit të këtij shtetasi në cilësinë e provës materiale u sekuestruan një pajisje kompjuterike dhe një telefon celular. Pas këqyrjes së këtyre pajisjeve rezultoi të përmbanin të dhëna të rëndësishme me interes për hetimin dhe më saktësisht: U gjetën 11 profile të rrjetit social "Facebook" me të dhëna të rreme, të cilat administroheshin dhe përdroheshin nga shtetasja Arben Bozhiqi. Gjatë këqyrjes së profileve që administroheshin nga ky shtetas u gjetën foto intime të vajzave të ndryshme, disa prej të cilave dyshohet se kanë qenë minorene në kohën kur këto foto janë realizuar si dhe dyshohet se këto foto janë marrë nëpërmjet marrjes së adresave të rr-

Hakëroi 3 mijë adresa në rrjetet sociale arrestohet 20-vjeçari, Arben Bozhiqi

Ndërhyrja në adresat e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, i gjenden dhe foto intime të vajzave minorene



Foto ilustruese

1200

ADRESA

Sipas policisë në kompjuterin e 20-vjeçarit Bozhiqi u gjetën 11 profile të rrjetit social "Facebook" me të dhëna të rreme, të cilat administroheshin dhe përdroheshin nga ai. Gjithashtu, u gjetën dhe mbi 1200 adresa të ndryshme të postës elektronike (e-mail, hotmail, yahoo, live etj.), të shtetasve të ndryshëm, mbi 400 kode hyrjeje (password) për adresa të ndryshme të rrjeteve sociale të shtetasve të ndryshëm etj.; mbi 100 adresa (URL) të faqeve të ndryshme të rrjetit social "Facebook" të shtetasve të ndryshëm.

jeteve sociale të këtyre shtetasve. Gjithashtu, u gjetën: Mbi 1200 adresa të ndryshme të postës elektronike (e-mail, hotmail, yahoo, live etj., të shtetasve të ndryshëm); mbi 400 kode hyrjeje (password) për adresa të ndryshme të rrjeteve sociale të shtetasve të ndryshëm etj.; mbi 100 adresa (URL) të faqeve të ndryshme të rrjetit social "Facebook" të shtetasve të ndryshëm si dhe mbi 50 link-e (adresa) të ndryshme, të cilat janë përdorur në periudha të ndryshme

kohe për të marrë (phishing) kodet e hyrjes së adresave të ndryshme të postës elektronike, rrjeteve sociale etj. Burime nga blutë pohan se Bozhiqi e ushtronte aktivitetin e tij kriminal që nga viti 2010 dhe gjatë kësaj periudhe kohore dyshohet se ka ndërhyrë në mbi 3000 adresa të rrjeteve sociale etj., të cilat kanë qenë të shtetasve shqiptarë dhe të huaj. Nga bisedat e kryera në rrjetet sociale rezultoi se kishte shkëmbim adresash me qëllime të ndryshme si fitimi

etj. Aktualisht po punohet për zbardhjen e plotë të këtij aktiviteti kriminal dhe personat, të cilët mund të jenë të lidhur me këtë shtetas. Materialet hetimore në ngarkim të 20-vjeçarit i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për veprimet të mëtejshme për veprat penale: "Ndërhyrja në të dhëna kompjuterike" si dhe për veprat, të cilat dolën gjatë hetimit "Falsifikimi kompjuterik" dhe "Hyryje e paautorizuar kompjuterike".

Vjedhja e serverëve të prokurorisë Durrës, shtyhen sërish hetimet

DURRËS - Gjykata e Durrësit ka vendosur të shtyjë sërish hetimin me kërkesë të prokurorisë së këtij rrethi për vjedhjen e dokumenteve dhe serverëve në institucionin e akuzës më 25 maj të këtij viti. Drini Pali e Pali Decolli, prokurorë të çështjes i kërkuan gjykatës shtyrjen e afatit të hetimeve, sepse nga laboratorit i ekspertizës kriminalistike nuk ka ardhur ende analiza biologjike e gjurmëve të gishtave të gjetura në një kaçavidë, e konsideruar prova kryesore e akuzës. Kaçavida është gjetur në zyrën e dhunuar të prokurorit Afrim Shehu, ndërsa pretendohet se në të janë gjurmë të gishtave të dy të arrestuarve: Artur Isa, 49 vjeç, banues në Sukth i Ri Durrës dhe Besnik Bushi 54 vjeç, banues në Durrës, që të dy me precedentë penalë të mëparshëm. Si bashkëpunëtor është arrestuar edhe roja private i godinës Njazi Lena, 56 vjeç. Mbrojtja ka kërkuar që të kryhet analiza biologjike, nëse ka apo jo gjurmë të të pandehurve, por prokuroria bëri me dije se laboratorit ka një defekt dhe nuk e kanë sjellë në kohë përgjigjen. Sipas mbrojtjes, të këto gjurmë është mbështetur prokuroria e Durrësit, në akuzën e bërë për të pandehurit, të cilët nuk e kanë pranuar autorësinë e krimit. **kl.ha.**



Shoqëria përbarimorë JUSTITIA

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza II, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna:
 T'ruaflë Ndërrës me sip. totale prej 250 m2, nga ku truall 250 m2, dhe ndërrësë 101 m2, nr. pasurisë 9/383, Vol. 16/ fq. 101, zona kadastrale 6532 me adresë L. "Sheq i Madh" Fir, e regjistruar në emër të Enver Demir Buzi
 Çmimi me të cilin fillon shitja në ankan është 3.276.000 (tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë
 Ankandi zhvillohet në datën 30.11.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza dyte, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna:
 Apartamenti me nr.pas.7/21-1-4, z.k.8360, vol.26, fq. 204, me sip.138.40 m2, Tiranë në pronësi të Gentian Kujtim TOSKU
 Çmimi me të cilin fillon shitja në ankan është 81.379 (tetëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) EUR.
 Ankandi zhvillohet në datën 04.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

STUDIO PËRBARIMORË GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA

Dl. 05.11.2018 ora 16:00
 Përfundon Ankandi i Dytë për pasuritë:
 - Pasuria "Lokali nr.4" me sip.66 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës.
 Me çmim 45 200 Euro
 - Pasuria "Lokali nr.5" me sip.43 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës.
 Me çmim 36 120 Euro
 - Pasuria "Lokali nr.6" me sip.110 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës.
 Me çmim 98 560 Euro
 Ankandi zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRBARIMORË GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Btv.kryesor (ish Kinma Iliria), Kati-2, Durrës, Kontaktat Çaj 0682096575

Një oficer i policisë greke do vijë në Shqipëri, mediat greke: Do marrë informacion

TIRANË

Vrasja e ekstremistit Konstandin Kaçifas në Bularat, babai: Të zbardhet vrasja e djalit

Ngjarja, Jani Kaçifas dëshmon për më shumë se 2 orë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda

Jani Kaçifas, babai i ekstremit grek që pesë ditë më parë u vra nga RENE A në fshatin Bularat të Gjirokastërës ka dëshmuar mesditën e djeshme në Prokurorinë e Krimeve të Rënda në Tiranë. Ai u paraqiti në ambientet e institucionit të akuzës rreth orës 12:00 së bashku me një përfaqësues ligjor të familjes dhe për më shumë se dy orë e gjysmë dha dëshminë në lidhje me ngjarjen e rëndë që ndodhi të dielën e kaluar. Mësohet se i ati i 35-vjeçarit Konstandin Kaçifas udhëtoi nga Gjirokastra në kryeqytet me një makinë me targa greke, i shoqëruar nga një grup i medieve të vendit fqinj. Mësohet se pas deklaratave të dhëna, i moshuari ka kërkuar zbardhjen e ngjarjes.



Jani Kaçifas, babai i 35-vjeçarit të vrarë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda

Jani Kaçifas u thirr nga grupi hetimor ende pa varrosur të birin, trupi i pajetë i të cilit po mbahet në ruajtje në morgun e Tiranës, deri në përfundim të ekspertizës mjekoligjore, për faktin se për mediat greke ka pretenduar se djali i tij është vrarë nga një distancë e afërt. Burime për "Gazeta Shqiptare" dje bënë me dije se përpara prokurorëve, ai ka kërkuar të hidhet dritë mbi ngjarjen ka mbeti i vrarë djali i tij, ndërsa ka kërkuar t'i lejohet marrja e trupit e të bëjë varrimin. Lidhur me këtë kërkesë të tij, prokurorët ende nuk kanë marrë një vendim, pasi presin daljen e ekspertizës, për të cilën ka pasur kundërshti. Me qëllim që ekspertiza të përfundojë në një kohë sa më të shpejtë, institucioni i akuzës thirrte me urgjencë në mbledhje edhe drejtuesit e mjekësisë ligjore. Derisa mjekët ligjorë të përfundojnë procedurën e tyre, grupi hetimor është fokusuar në pyetjet e familjarëve të viktimës dhe lidhjeve shoqërore të tij. Ndërsa, më herët ka sekuestruar pamjet filmike të operacionit në repartin RENE A për të hetuar nëse specialët e përshirë në aksionin për kapjen e minoritarit grek që përfundoi me vrasjen e tij kanë vepruar ose jo në përputhje me ligjin. Nga ana tjetër, mediat greke njoftuan se për çështjen "Kaçifas", do të vijë në Shqipëri një ekip i policisë greke së bashku me një zyrtar të Ministrisë së Jashtme, ku do të takohen me drejtuesit e policisë shqiptare në lidhje me vrasjen e 35-vjeçarit. Ndërkaq, mësohet se oficeri grek nuk mund të marrë pjesë në hetime, çka do të thotë se lidhur me ngjarjen, gjithçka është në duart e autoriteteve shqiptare. Lidhur me hetimin penal të çelur në Greqi, prokuroria shqiptare thotë se do t'i përgjigjet interesimit të institucioneve atje vetëm përmes letërporsive.

DEKLARATA E KATROUGALOS

Zëvendësministri i Jashtëm, grek Jorgos Katrougalos deklaroi dje për mediat në Athinë se hetimet për vrasjen e minoritarit në Gjirokastër janë test për negociatat mes dy vendeve. Ai u shpreh se është në kontakt me Tiranën zyrtare mbi ecurinë e hetimeve. "Jemi në kontakt me autoritetet diplomatike të vendit fqinj dhe prioritetet tona janë: të hidhet dritë mbi çështjen dhe të mbrohet të drejtat e vëllezërve tanë grekë që jetojnë atje. Deri tani kishim evoluar në progresin e negociatave diplomatike mes dy vendeve. Me të vërtetë është një test sesi do të avancojë kjo çështje me drejtësinë shqiptare. Nuk dua të paragjykoj, dua të shpresoj që do të kemi zhvillimin që të gjithë presim dhe shpresojmë", tha Katrougalos.

"Konstandini ishte i qetë, u bë luftë e madhe"

Ekzekutimi i 35-vjeçarit nga RENE A, Bariu: I dhashë për të pirë ujë dhe një xhup

GJIROKASTËR - Në lidhje me ekzekutimin e 35-vjeçarit Konstandin Kaçifas ka folur për mediat greke një bari i zonës së Bularatit, i cili ishte personi i fundit që e takoi atë para se të qëlluhej për vdekje nga RENE A. Ai ka treguar detaje të reja për ngjarjen, ndërsa ka pohuar se është taktuar me Konstandinin, madje e ka ndihmuar duke i dhënë ujë për të pirë. "Konstandinosin e pashë, biseduam, u ulëm dhe i dhashë ujë. Pastaj i dhashë xhupin, sepse ishte ftohtë. Ai ishte i qetë. Më pas luftë të madhe. Më pas shkova te delet dhe e humba nga sytë, ai u zhduk", është shprehur bariu për



Konstandin Kaçifas



Bariu duke folur për mediat greke

"SKA TV". Gjithashtu, ai ka folur edhe për mbërritjen e helikopterit të forcave RENE A në Bularat të Gjirokastërës, të dielën e shkuar, ndërsa situatën e përshkruan si një luftë të madhe. "Pashë helikopterin dhe fatmirësisht nuk mora ndonjë plumb,

ishte një luftë e madhe", shtoi ai. Ndërkohë, trupi i pajetë i 35-vjeçarit nuk është përcjellë për në banesën e fundit për shkak të pretendimeve nga ana e familjarëve, të cilët kanë kërkuar ekspertizë tjetër me ndihmën edhe të palës greke.

"Dëmshtëpërbleni familjet e 4 viktimave"

Rikthehet në gjykatën e Tiranës "21 janari", Garda, padi ndaj Ndreja Prendit dhe Agim Llupos

TIRANË - Garda e Republikës ka paditur ish-drejtuesin Ndreja Prendi dhe efektivin Agim Llupo duke kërkuar që ata të paguajnë faturën e dëmshtëpërblimit për 4 viktimat e "21 Janarit". Burime pranë Ministrisë së Brendshme bëjnë me dije për TV "Klan" se përmes një padie civile, Garda kërkon nga Gjykata e Tiranës që ish-komandanti Ndreja Prendi dhe ish-shefi i njësisë special, Agim Llupo të dëmshtëpërblenë familjet e 4 viktimave si dhe të mbulojnë shpenzimet gjyqësore që kapin vlerën e 2.1 milionë eurove. Seanca e parë do të zhvillohet ndaj ish-kreut të Gardës, Ndreja Prendi më datë 6 nëntor në orën 14:00. Ende nuk është



Viktimat e 21 Janarit

caktuar seanca në ngarkim të Agim Llupos, që mbante postin e shefit të njësisë speciale në Gardën e Republikës në kohën kur ndodhën vrasjet. Dy ish-zyrtarët e Gardës u shpallën fajtorë për "Vrasje me dashje nga pakujdesia", duke dënuar me 1 vit burg Ndreja Prendin dhe 3 vite Agim Llupon. Në dhjetor të 2017-ës qeveria "Rama" miratoi një vendim për dëmshtëpërblimin e katër familjeve të viktimave, Ziver Veizi, Hekuran Deda, Aleks Nika dhe Faik Myrtaj. Këta të fundit protestave të vrarë gjatë protestave të opozitës në 21 janar të 2011.

Sekuestrohen tritol, armë dhe drogë, kapen dy vëllezër

TIRANË - Policia e Tiranës, në kuadër të operacionit "Ndëshkimi i 'të fortëve' ka arrestuar tre persona, dy prej të cilëve vëllezër. Bëhet fjalë për 26-vjeçarin Kastriot Gazidede dhe 16-vjeçarin S.G., të dy banues në kryeqytet. "Arrestimi i dy vëllezërve u bë pasi në Pezë Helmës gjatë kontrollit të ushtruar nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr.5, në mjetin tip "Mercedes Benz" me drejtues shtetasin Kastriot Gazidede dhe pasagjer shtetasin S.G., u gjetën dhe sekuestruan 17 kallëpe tritol, një armë zjarri automatike dhe 1.2 kg kanabis", tha policia. Në pranga ka përfunduar dhe Lulzim Aruci, 45 vjeç, banues në Shtitsh, pasi iu gjet dhe iu sekuestrua një automatik.

Permbuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankap pasurine :

a) Tokë are e rregjistruar në regjistrin hipotekore me nr pasurisë 144/25 në Zonën Kadastrale 3217 me nr prone volumi 2, Fq 195, me sip totale 1937 m² e ndodhur në fshatin Rashkullaj / Gruemirëv, Malsi e Madhe. Cnimi për hapjen e ankandit është në vlerën 292,674 leke .

b) Trulli + Ndërtese e rregjistruar në regjistrin hipotekore me nr pasurisë 153/27 në Zonën Kadastrale 3217, me nr prone Volumi 2, Fq. 195 me sip totale 1900 m², nga kjo Trulli 200 m² , Ndërtese 50 m² e ndodhur në lagjen Rashkullaj Gruemirëv, Malsi e Madhe. Cnimi për hapjen e ankandit është në vlerën 199,180 leke

Shija e pasurisë do të behet (zhvillohet) me date 05.11.2018 ora 16,16 në Zyren e permbuesit gjyqësor Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko, Portale Gjyqësore të rrethit Gjyqësor Shkodër. Porsorat e interesuar duhet të derdhen para fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkodër me nr logario 41064051.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimorë "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 01 Dhjetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përbarimorë do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e II-të, për shitjen e apartamentit nr. 3/218+1-18, vol 35, fq.39, ZK.8350, sip. 103.90 m² me gmin fillestar 57120 lek/m².

Apartamenti ndodhet në Tiranë (prapa Prokurorisë Rrethit Tiranë).

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Njoftim për shitje me ankap

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k në baza të nenit 567.568 të K.Pr. Civile do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e debitorit S.Shera, dhe O.Shera. Pasuria që shitet në ankap përbëhet nga: "Dygan" me numër pasurie 6/279, Vol. 37, Fq.64, në Z.K Nr. 8350, me sipërfaqe 35 m², e në Zrrip Tiranë, me numër pasurie 6/279, Vol. 37, Fq.64, në Z.K Nr. 8350, me sipërfaqe 4.8 m², në Zrrip Tiranë Ankandit, i pasurisë "Dygan" fillon me çmimin fillestar në masën 36.400 Euro "Dygan", me numër pasurie 6/279, me Z. Nr. 8350, me sipërfaqe 4.8 m², në Zrrip Tiranë Ankandit, i pasurisë "Dygan" fillon me çmimin fillestar në masën 3.840 Euro Ankandit do të zhvillohet në datë 12.11.2018 prej orës 15:00 në selin e shoqërisë Bulv "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr. 5. Ofertuesit mund të paraqiten ose të kontaktojnë tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.

ARSIMI PARAUNIVERSITAR PROBLEMATIKAT

Alma Lama: Kemi 7 vjet pa marrë shpërblimet e fundvitit, dhe pagesat e kujdestarisë

Voltiza Duro

"Rebelohen" mësuesit: Notat e nxënësve të mos hidhen në regjistrat personale

"Kjo praktikë lë vend për abuzim, ngelet të veprohet sipas ndërgjegjes personale"

Mësuesit e arsimit parauniversitar në vend kërkojnë një rimodelim të regjistrat të shkollës. Prej disa vitesh, me vlerësimin e kurrikulës me kompetenca, mësuesit i hedhin notat e nxënësve në regjistrin personal, të cilin e marrin me vete dhe në shtëpi. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Alma Lama, mësuese kimie, njëkohësisht edhe kryetare e Sindikatës së Pavarur të Arsimit për Tiranën, pjesë e SPASH, thekson se kjo praktikë lë shumë vend për abuzim e gjithçka ngelet në ndërgjegjen personale të mësuesit. Ajo më tej shton se kjo është një shpikje alla shqiptarçe pasi në vendet e Evropës zbatohet kurrikula me kompetenca, por ka sisteme dixhitale të vlerësimit. Mësuesja e Kimisë bën me dije se prej 7 vitesh mësuesit e arsimit parauniversitar në Shqipëri nuk marrin shpërblimet e fundvitit e deri më tani nuk ka një predispozitë nga ana e ministrisë edhe për këtë fundvit. Ndërkohë për tri vite në Tiranë orët e klasës kujdestari nuk u trajtuan si normë, e mësuesit u detyruan t'i mbanin mbi normën mësimore javore. Problem mbeti pagesa për orët e klasës kujdestari për klasat nga e para tek e pesta. U zgjidh problemi për mësuesit e klasave VI-XII, por sollti ndjenjë e diskriminimit të mësuesit e ciklit fillor. Lama shton se një tjetër problem është portali i Kryeministrit për bashkëqeverisje pasi nxit shpifjen dhe zbeh rolin e organeve si Këshill Etike dhe Komision Disiplinë në shkollë.

Si mendojnë mësuesit lidhur me vlerësimin e kurrikulës me kompetenca? Mësuesit në masë kërkojnë që notat të hidhen në regjistrin e klasës. Kërkojnë të rimodelohet regjistri aktual. Viti mësimor ka dy muaj që ka filluar dhe notat janë në çantën time dhe në çantën e çdo mësuesi tjetër, pra mësuesi i mban vlerësimet në regjistrin e tij personal. Në regjistrin e klasës hidhen vetëm mungesat, në një kohë që notat i kanë mësuesit e shëtisin bashkë me ta. Ngelet në



Alma Lama, mësuese e lëndës së kimisë



PROBLEMATIKAT

Një tjetër problem portali i Kryeministrit për bashkëqeverisje. Ky portal nxit fenomene të paprecedente duke nxitur shpifjen dhe zbeh rolin e organeve si Këshill etike dhe Komision disiplinë në shkollë. I ftoj prindërit dhe qytetarët të heqin dorë nga format spiune kundra mësuesit, portale dhe anonime! Jeni duke dëmtuar rëndë raportin mësues-nxënës.

ABUZIMET ME SISTEMIN

Natyrisht që lë vend për abuzime! Në klasat 10, 11, 12 kërkohet një ndërgjegje shumë e lartë e mësuesit! Pas çdo 3 mujori depozitohen në drejtori evidencat e notave, kjo konsiderohet humbje kohë nga ana e mësuesit, pasi duhet t'i rihedhin sërish vlerësimet që kemi në regjistrat personal. Kjo evidencë ka vlerë vetëm për një vit dhe pastaj është e pavlefshme. Kjo praktikë lë vend për abuzim brenda dhe ngelet të veprohet sipas ndërgjegjes personale.

ndërgjegjen e çdo mësuesi që vlerësimet t'i ndryshojnë apo t'i mbajnë siç janë. Pasi përfundon 3 mujori këto nota hidhen në regjistrin e klasës, pra hidhet përfundimtarja e një vlerësimi të vazhduar, një vlerësimi të portofoli dhe një vlerësimi të testit. Kjo praktikë po zbatohet që me aplikimin e kurrikulës me kompetenca. Kjo është një shpikje alla shqiptarçe. Në vendet e Evropës zbatohet kurrikula me kompetenca, por ka sisteme dixhitale të

vlerësimit.

A lë vend për abuzime në sistem i tillë vlerësimi?

Natyrisht që lë vend për abuzime! Në klasat 10, 11, 12 kërkohet një ndërgjegje shumë e lartë e mësuesit! Pas çdo 3 mujori depozitohen në drejtori evidencat e notave, kjo konsiderohet humbje kohë nga ana e mësuesit, pasi duhet t'i rihedhin sërish vlerësimet që kemi në regjistrat personal. Kjo evidencë ka vlerë vetëm për një vit dhe

pastaj është e pavlefshme. Kjo praktikë lë vend për abuzim brenda dhe ngelet të veprohet sipas ndërgjegjes personale.

A i kanë marrë mësuesit pagesat e klasës kujdestari?

Për tri vite në Tiranë orët e klasës kujdestari nuk u trajtuan si normë, mësuesit u detyruan t'i mbanin mbi normën mësimore javore. Udhëzimi 30 i shtator 2018 e zgjidhi më në fund këtë ngërç. Kjo është arritje e Sindikatës së Arsimit. Problem mbeti pagesa për orët e klasës kujdestari për klasat nga e para tek e pesta. U zgjidh problemi për mësuesit e klasave VI-XII, por sollti ndjenjë e diskriminimit te mësuesit e ciklit fillor. Një mësues që ka klasën e parë apo të dytë bën 19 orë mësim, shto edhe 2 orë të klasës kujdestari shkojnë 21 orë. Një mësues që është në klasë kujdestari të tretë, të katërt, apo të pestë ka 21 orë, shto dhe dy orë kujdestari shkojnë 23 orë. Mësuesit e ciklit fillor mendojnë se janë të diskriminuar për këtë situatë.

Si e vlerësoni nisimën 3

lëndë në 6 orë?

Vlen të theksoj se nisma 3 lëndë në 6 orë i ka ndarë mësuesit në përkrahës të saj dhe skeptikë. Por dua të them se të gjithë mendojnë që vëmendja në orën e dytë bie ndjeshëm nga ana e nxënësve, ata ndihen të lodhur, por në një kohë që në shtëpi kanë më pak detyra.

Një tjetër problematikë shqetësuese për mësuesit ka qenë fakti që nuk kanë marrë shpërblimet e fundvitit. A vazhdon ende ky shqetësim apo i është dhënë zgjidhje?

Mësuesit janë shumë të interesuar dhe natyrisht që kërkojnë të zbatohet Kontrata Kolektive, neni 10.12, ku detyron punëdhënësin për të kryer shpërblimin vjetor të mësuesve në sistemin e arsimit publik parauniversitar. Po bëhen 7 vite që nuk po i marrim. Nuk jam në dijeni nëse ka një predispozitë nga ana e ministrisë që ne t'i marrim këtë fundvit. Ne dijin në time ky fond i shpërblimit ka kaluar në Ministrinë e Financave.

Cilat janë problematikat e tjera që shqetë-

sojnë mësuesit?

Një tjetër problem portali i Kryeministrit për bashkëqeverisje. Ky portal nxit fenomene të paprecedente duke nxitur shpifjen dhe zbeh rolin e organeve si Këshill etike dhe Komision disiplinë në shkollë. I ftoj prindërit dhe qytetarët të heqin dorë nga format spiune kundra mësuesit, portale dhe anonime! Jeni duke dëmtuar rëndë raportin mësues-nxënës. Përdorni organet këshillimore në institucione, këshill etike, këshill disiplinë. Sindikata e arsimit do të mbrojë fort çdo formë abuzive ndaj kujt do mësuesi!

A kenë bërë ndonjë kërkesë pranë MASR për zgjidhjen e problemeve të sipërpërmendura?

Për problemin me regjistrat dhe vlerësimin e kurrikulave me kompetenca kemi bërë vetëm një takim, ndërkohë që na është premtuar një takim i dytë. Na u premtua që do të kishim një rikonceptim të regjistrat për këtë vit të ri mësimor. Kërkojmë që të organizojmë një takim me MASR.

KOLEGJI UNIVERSITAR "LUARASI" TAKIMI



Dje gjatë vizitës së ambasadores së Kinës në Republikën e Shqipërisë Jiang Yu në ambientet e Kolegjit Universitar "Luarasi"

Voltiza Duro

Rektori Ethem Ruka: Bashkëpunim i frytshëm së shpejti. Shkëmbihen dhurata simbolike

Universiteti "Luarasi" pret ambasadoren kineze për bashkëpunim në fushën arsimore

Jiang Yu: Miqësia mes "Hysenbelliu Group" e ambasadës kineze

Në kuadër të bashkëpunimeve të vazhdueshme me institucionet e arsimit të lartë në shtete të tjera, Universiteti "Luarasi" ka pritur në një takim ambasadoren kineze në Republikën e Shqipërisë, Jiang Yu. Gjatë bashkëbisedimit me stafin akademik të Luarasi-t dhe studentët, ambasadorja kineze ka theksuar se ndihet e nderuar që vizitonte këtë universitet, me qëllim forcimin e shkëmbimit arsimor dhe arritjen e marrëveshjeve bashkëpunuese. Më tej Yu ka vlerësuar edhe miqësinë e Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës me "Hysenbelliu Group", i cili ka dhënë kontribut maksimal për rritjen e Universitetit "Luarasi" ndër vite. "Në epokën e re, marrëdhëniet kineze-shqiptare po zhvillohen në mënyrë të gjithanshme dhe shpejtë, me një perspektivë premtuese. Miqësia tradicionale kineze-shqiptare duhet të trashëgohet nga brezat e rinj, që duhet të njohin më thellë njëri-tjetrin. Dua të theksoj se Ambasada e Republikës Popullore të Kinës dhe 'Grupi Hysenbelliu' janë miq dhe unë jam e nderuar të vizitoj Universitetin 'Luarasi'. Sot kam ardhur këtu për t'u njohur me ju, dhe kam sjellë 100 libra rreth Kinës për bibliotekën tuaj. Shpresoj që shkëmbimi arsimor mund të përforcohet. Vitet e fundit, mësimi i shqipërisë në Kinë dhe mësimi i kinezishtes në Shqipëri po zhvillohen shumë shpejtë. Shpresoj që të dyja palët mund të zhvillojnë më shumë shkëmbime arsimore dhe rinore, të pasurojnë bashkëpunimet në fushat e ndryshme, për të çuar më përpara shkëmbimin dhe bashkëpunimin midis dy vendeve tona dhe për të pasuruar marrëdhënien dypalëshe", - u shpreh ambasadorja. Ndërkohë, rektori i "Luarasi", prof. dr. Ethem Ruka i ka shprehur mirëseardhjen ambasadores kineze dhe ka theksuar se



stafi akademik e studentët ndihet të nderuar nga kjo vizitë.

"Jemi shumë fatlumë që po na viziton edhe zonja ambasadore me plot dhurata të bukura. Na keni nderuar me praninë tuaj dhe jam i bindur që këto marrëdhënie nuk janë thjesht marrëdhënie ceremoniale. Shpresoj që këto mar-

rëdhënie të thellohen", - tha Ruka në fjalën e tij.

VIZITA TE "LUARASI"

Më pas ambasadorja kineze Jiang Yu, shoqëruar nga stafi akademik ka vizituar ambientet e universitetit "Luarasi". Ajo ka vlerësuar së tepërmi, një nga pikat më të forta të këtij institucioni arsimor të lartë, gërshtimin e teorisë me prak-

tikën. "Gjatë vizitës në universitetin 'Luarasi' po shikojmë profesionalizmin tuaj, ju jeni me të vërtetë shumë profesionistë. Deri më tani kam parë që mësimdhënia në universitetin tuaj, bazohet në gërshtimin e teorisë me praktikën dhe ju përdorni shumë eksperiencën praktike. Kjo është diçka shumë e mirë sepse mund të lidhet studimi në shkollë me praktikën në të ardhmen", - tha Jiang Yu. Sakaq, prof. dr. Ethem Ruka theksoi se marrëdhëniet me institucionet e arsimit të lartë në Kinë së shpejti do të kthehen në një bashkëpunim të frytshëm. "Ishte një takim mjaft i mirë në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar midis Universitetit 'Luarasi' dhe institucioneve arsimore të tjera.

Zonja ambasadore e Republikës së Kinës pati rastin të komunikonte edhe me studentët të Fakultetit të Drejtësisë si dhe me pedagogët. Shpresoj që shumë shpejt ne të arrijmë në marrëveshje bashkëpunimi. Zonja ambasadore shprehu gatishmërinë për të nxitur më tej këtë bashkëpunim në të ardhmen", - shtoi rektori. Në fund të takimit, ambasadorja kineze dhe "Luarasi" kanë shkëmbyer disa dhurata simbolike, mes tyre edhe 100 libra rreth historisë e kulturës së Kinës, që pasuruan bibliotekën e universitetit. Njëpërmjet bashkëpunimeve të tilla, "Luarasi" dëshmon edhe njëherë se vazhdon të mbetet një ndër liderët e arsimit të lartë në vend, duke ofruar praktika e eksperiencën

ETHEM RUKA

"Jemi shumë fatlumë që po na viziton edhe zonja ambasadore me plot dhurata të bukura. Na keni nderuar me praninë tuaj dhe jam i bindur që këto marrëdhënie nuk janë thjesht marrëdhënie ceremoniale. Shpresoj që këto marrëdhënie të thellohen", - tha Ruka në fjalën e tij.

që do të formojnë profesionistët e së ardhmes.

Takimi me përfaqësuesit e universiteteve kineze

Rreth një javë më parë, Universiteti "Luarasi" priti në takim një delegacion me përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë në Kinë. Në kuadër të bashkëpunimeve të vazhdueshme me universitete prestigjioze në mbarë botën, stafi akademik i "Luarasi" diskutoi me delegacionin e arsimit kinez, mbi shkëmbimin e pedagogëve dhe mundësinë e dhënies së bursave për studentët. Gjithashtu, në takim u shqyrtuan mundësitë e punëve kërkimore të përbashkëta dhe shkëmbimin e informacioneve në fushën e kurrikulave ndërmjet universiteteve kineze dhe "Luarasi". Rektori i "Luarasi", prof. dr. Ethem Ruka prezantoi universitetin para delegacionit e më tej dekanët pasqyruan punën e 3 fakulteteve në këtë institucion të arsimit të lartë. Në këtë takim ishte e pranishme edhe zëvendës drejtoresha e arsimit të lartë pranë Bashkisë së Pekinit, e cila u shpreh se stafi akademik i "Luarasi" ishte shumë mikpritës. Ajo më tej theksoi se universitetet kineze kanë dëshirën e madhe për bashkëpunime me "Luarasin". Në fund të takimit, delegacioni kinez i dhuroi universitetit "Luarasi" disa dhurata simbolike në shenjë mirënjohjeje për mikpritjen dhe profesionalizmin e stafit akademik.



CEREMONIA

Willy Kamsi

Biblioteka e rrallë e pinjollit të Engjëllorëve u la dhuratë me amanet

Fatmira Nikolli

Librat e vjetër, sendet personale të Fishtës e Gurakuqit, e jeta e Willy Kamsit



Në foto: Willy Kamsi

Letra të shkrimtarëve të ndryshëm, dy stilografë që Gjergj Fishta ua ka dhuruar kur vizitonte shtëpinë e tyre në Bari dhe qindra e qindra libra të vjetër të botuar jashtë vendit para vitit 1945. Gjithë Biblioteka e tij e rrallë është kjo dhuratë që Willy Kamsi i ka lënë Bibliotekës Françeskane në Shkodër. Duke pasur parasysh shumë biblioteka të njerëzve të njohur në Shkodër që qenë zhdukur e zhbërë, Kamsi e la me porosi sa qe gjallë, ndaj e motra, Miriam, sot, ia bën dhuratë bibliotekën e familjes, Françeskanëve që ajo të jetë e shfrytëzueshme nga të gjithë.

"Arkivi asht mjaft i pasun, me shkrime të pabotueme të Gjon e Willy Kamsit. Kësisoj, kemi edhe objekte fort të çmueshme, siç janë dy penda dhurue nga At Gjergj Fishta, për Willy Kamsin dhe të motrën Miryam Kamsin. Ndër materialet me randesi kemi edhe dhanitë që Luigj Gurakuqit i dërgon me rastin për martesës së Gjon Kamsit. Kjoftë librat dhe materialet arkivore do të ruhen pranë Bibliotekës Françeskane në Shkodër në një ardhme shumë të afërm do të vendosen në muzeun françeskan që do të ndërtohet së shpejti", tha frat Vitor Demaj dhe për "Gazeta Shqiptare".

Dorëzimi i bibliotekës bëhet sot me 3 nëntor në orën 11.00 në Kuvendin Françeskan të Gjuhahadolit në Shkodër.

KUSH ISHTE WILLY GJON KAMSI

Ka lindur në Bari (Itali) më 17 dhjetor 1926 dhe është pagëzuar në Bazilikën e Shën Pjetrit në Romë. Rrjedh nga familja e Engjëllorëve të Drihsitit, përfaqësues i shquem i së cilës ka qenë Arqipeshkvi i Durrësit Pal Engjëlli, autor i të parit dokument të gjuhës shqipe, Formulës së Pagëzimit (1462). I ati Gjon Kamsi, ka qenë bashkëpunëtor i Luigj Gurakuqit, anëtar i Këshillit Kontrollues, Këshilltar i Bankës Kombëtare dhe autor shkrimesh të shumta me karakter ekonomik, ndërsa ungi i tij Kolë

Kamsi është dallue si studiues i botës arbreshe dhe folklorist. Willy Kamsi ka ndjekë shkollën filllore dhe të mesmet në qytetin e lindjes në "Instituti, De Cagno Abbrescia" të drejtuar prej Etëve Jezuitë. Mbas kthimit të familjes në atdhe, me 1943, duke qenë të mbyllura shkollat, endë student, në vitin 1944, nën drejtimin e Prof. Filip Fishtës, studiues i shquar, ka punuar përkohësisht në Bibliotekën e Institutit të Studimeve Shqiptare në Tiranë. Në vitin 1948 merr maturën në Gjimnazin e Tiranës. Më 1953, mbas pushtimit komu-

nist, si ka ndodhur edhe për familje të tjera shkodrane me banim në Tiranë, edhe familja e tij dëbohet dhe dërgohet në Shkodër. Në fillim ka punuar përkohësisht e vullnetarisht në bibliotekën e qytetit dhe më vonë në zyrën teknike të Bashkisë Shkodrës, ku vijoi punën deri më 1963. Në këtë vit emërohet përgjegjës i Bibliotekës së Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës. Në këtë detyrë ka vijuar deri në vitin 1990, gjatë 27 vjetëve. Rrit fondin e saj biblioteka nga 10.000 vëllimet fillestare në 120.000 libra dhe koleksione revistash, duke

TITUJT LIBRASH TË DHURUAR

- PAGANEL, Camille: Histoire de Skanderbeg ou Turks et Chrétiens au XVIe siècle. Paris, Didier, Libraire-Editeur, 1855. d-ixxiv-464-8 ff.
- PAGANEL, Camille: Geschichte Skanderbeg's oder Türken und Christen im fünfzehnten Jahrhundert, Tübingen, H. Laupp'schen Buchhandlung, 1856. 410 ff.
- ZONGADA, Antonio: Scanderbeg. Storia albanese del secolo XV. 2da edizione. Milano, Casa Edit. Ditta Giacomo Agnelli, s.a. X-332 me 2 ff. il. + 498 ff. me 1 ff. il.
- SCAPOLLO, Emilio: Venezia e Albania. Saggio documentato delle relazioni Veneto-Albanesi nei secoli XIV-XV. Fascicolo I°. Venezia, Istituto Veneto di Arti Grafiche, 1908. 27 ff.
- [GURAKUQI, Luigj]: Abëtar i vogël shqyp mas Abëvët t'Bashkimit ë t'Stambollit më trëgimë n'ydy dialëktët prej Lék Grudes. Bukurect, Ne shtypet? N.N. Voicu, 1906. 28 ff.
- [GURAKUQI, Luigj]: Abëtar për msotorë filltarë t'Shçypnis. Libri i pare. Napoli, Tip. Edit. A. Toço & A. Salvietti, 1905. 88 ff. .
- [GURAKUQI, Luigj]: Fjalorth shqyp-frëngisht e frëngisht-shqyp i fjalëve t'rëja. Napoli, Tip. Edit. Toço & Salvietti, s.a. 30 ff.
- [GURAKUQI, Luigj]: Knimë për msotorë filltarë t'Shçypnis. Libri i dyte. Napoli, Tip. Edit. A. Toço & A. Salvietti, 1905. 96 ff.
- [GURAKUQI, Luigj]: Vargenimi n'gjuhë shqypë me gni Fjalorth shqyp-frëngisht n'marin. Napoli, Tip. Edit. Toço & Salvietti, s.a. 142 ff.
- GJECOV O.F.M., A. Shtjefni Konstantini: Agjimi i gjyterinis. 1910. Shkoder, Shtyp. "Nikai", 1910. 144 ff.
- GJECOV O.F.M., A. Shtjefni Konstantini: Atil Reguli. Dramë me tri pamje. Shqyptimi i lirë mas Pjeter Metastasi (1905) (Pro manuscripto). Shkoder, Shtyp. "Nikai", 1912. 64 ff. (Klubi "Gjuha Shqype" n'Shkoder, 7).
- Historija sëjje per Škoce te para te Ščypnenise. S.I., s.e., s.a. 68 ff. me il.
- [FISHTA O.F.M., P. Gjergj]: Anzat e Parnasit. N'Sarajev. "Bosn. Post", 1907. 68 ff.
- [FISHTA O.F.M., P. Gjergj]: [Preje gni Mësharitari Shçypiaar]: Komsia e Klëri Katolik. S.I., s.e., 1907. 30 ff.
- [FISHTA O.F.M., P. Gjergj]: Lahuta e Maltsiis. Känge popullore. Blëe i pare. S.I., s.e., s.a. 50 ff.
- [FISHTA O.F.M., P. Gjergj]: Lahuta e Maltsiis. Blëe dyte. N'Zader, Shtypeshkroie e Vitalianit, s.a. 62 ff.
- FISHTA, A. Gjergj: Mii vorr t'A. Anton M. Xanonit S.J. S.I., s.e., s.a. 8 ff.
- FISHTA O.F.M., P. Gjergj: Pika voëset. Zader, Shtypshkrojë Ernestos Vitaliani-t, 1909. 62 ff.
- FISHTA O.F.M., P. Gjergj [P. Gj. F.]: Sh'Fransesku i Asizit. Melodram. Shkoder, Shtyp. "Nikai", 1912. 100 ff.



krijuar njëkohësisht prej themelit një fond albanobalkonologjik që endë sot, mbas Bibliotekës Kombëtare mbahet ndër më të mirët në Shqipëri, me libra të blerë kryesisht nga familjet katolike të Shkodrës. N'atë kohë ndjek studimet e larta dhe merr diplomën në histori-geografi në vitin 1975. Mbas shembjes së regjimit komunist me Dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, dr. Sali Berisha, emërohet ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë pranë Selisë së Shënjtë. Është i pari ambasador, mbasi shteti Shqiptar që kurr nuk ka pasë marrëdhënie diplomatike me Selinë e Shejtë. Këto vendosen për herë të parë në vitin 1991. Letrat kredenciale i paraqet me 22 prill 1993, tri ditë para Vizitës së Atit të Shënjtë në Shqipëri (15.IV.1993). Në këtë detyrë qëndron deri në dhjetorin e vjetit 1996.

Qysh në moshë të rë është marrë me studime albanologjike. Më 1960-1961 ka drejtue punimet restauruese konservative në Këshillës mesjetare të Shkodrës. Ka marrë pjesë në mënyrë aktive në gjurmime arkeologjike e në studime e monumenteve, sidomos mes-

jetare si dhe në konferenca, simpoziume e mbledhje të tjera me karakter shkencor historik. Studimet e tjera janë të botueme në revista të ndryshme si të Tiranës ashtu edhe të Shkodrës: Studime gjuhësore (Tiranë), Monumentet (Tiranë), Buletini Shkencor (Shkodër), Kuartari i Muzeut (Shkodër) Phoenix (Shkodër), "Shkoda ndër shekuj" (Shkodër) dhe botime të tjera. Ka përkthyer vepra të ndryshme albanologjike nga italishtja, frëngjishtja, e anglishtja. Ndër to ka gati për shtyp prej Imzot Ernesto COZZI tri studime në lidhje me fiset shqiptare, gjakmarrjen dhe gruen shqiptare, prej Gorrit T.A. GOSLINGA Holandezë në Shqipëri. Më 1999 merr pjesë në Simpoziumin e 2-të parasindod (11-14 janar 1999) kushtue "Krishtit burim i një kulture së rë për Europën në prag të mijëvjeçarit të tretë" tue qenë moderator m'atë rasë në njeinin ndër sesionet. Kurse më 2205 në Kuvendin Ndërkombëtar të mbajtur në Universitetin e Napolit "L' Orientale" paraqitet me kumtesën: Thirrja e krishtenë dhe europiane e Gjergj Kastriotit Skanderbegut

Ka punue në part time në

Koncerti, sonte te Salla e Katedrales Ortodokse, në program sonatat e Bethovenit

Tedi Papavrami: Koha e vështirë e divorcit dhe koha e artë e muzikës

Violinisti rrëfen jetën profesionale e atë personale



Në foto: Tedi Papavrami

Prtej artistit që interpreton symbyllur në skenë, prej kohës kur botoi kujtimet e librit "Fugë për violinë", kemi mundur të gjejmë edhe njeriun. Madje, ta ndiejmë e të kuptojmë se kush është Tedi Papavrami, kur lë violinën, del nga dhoma e provave e hyn në jetën e tij. Sontë është me koncert në Tiranë në sallën e Katedrales Ortodokse e djep para mediave, teksa foli për koncertin, u ndal edhe te jeta e tij, përjetimet e vështira, ndarja me ish-bashkëshorten, vuajtja, kohët që u dëshen për ta kaluar, rigjetyja e dashurisë, te një martesë tjetër që e bën të lumtur dhe i jep violinistit, njeriun e qetë, që është në jetën personale po aq i paqët sa në atë profesionale. Ai i thotë të gjitha me sinqeritet, pa komplekse, duke pranuar se ka çaste që ngecim, rrëzohemi e më pas ringrihem, sërish e sërish. Papavrami iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve të pranishëm si vijon.

- Si ndihet tani violinisti përtej violinës?

Ndihem mirë. Pas një periudhe që ishte e vështirë në fakt që nga koncertet e fundit që dhashë në Tiranë, "Sonatat dhe partitat e Bahut". Pata ndryshime në jetën time, u ndava nga ish-gruaja ime. Si për çdo njeri këtu janë gjëra të vështira pasi kishim 21 vite që je tonim bashkë. Ishim rritur bashkë në një farë mënyre dhe kjo u reflektua edhe në lojën time dhe e ndjeva veten jo mirë për mjaft kohë. Madje gjërat dalëngadalë morën një rrugë më të mirë dhe që prej një viti e gjysmë jam martuar me Maki Okada, me origjinë japoneze dhe që ka ardhur të jetojë me mua në Gjenevë, në Zvicër. Jam vërtet shumë më i qetë dhe më i lumtur, më duket vetja shumë më fat që kam gjetur një njeri kaq të mrekullueshëm me të cilin mund të ndajmë shumë gjëra. Plus që është gjithashtu pianiste dhe mund të luajmë bashkë, kështu që kemi një komunikim më të gjerë, pasi përfshin edhe muzikën. Përpara mendja se është e vështirë jetesa me një muzikant, pasi hyn pak në konflikt, pasi ke të njëjtat kërkesa dhe presioni të vazhdueshëm, po fatmirësisht nuk po ndodh shumë dhe ne po ndihemi shumë mirë me njëri-tjetrin.

- Kur do të jeni në Tiranë për një koncert të dy?

Më vonë me siguri, përdërisa luajmë duo në vende të tjera përse të mos e bëjmë në Shqipëri, por kësaj radhe programi ishte me pianistin François-Frédéric Guy po sigurisht që do të ndodhë, do të ndodhë më vonë, por tani jam shumë i lumtur që t'i tregoj vendin. Sot po i tregoj se kjo rrugë të çon aty ku ishte dikur shtëpia jonë, që është shumë afër në fakt dhe që do të shkojmë sapo të kem pak kohë, sepse po bëjmë prova. Është zbulimi i vendit tani për tani, por që do të ketë raste sigurisht.

- Dukeni optimist, ngjan se pranvera e Bethovenit të ka ndryshuar...

Në fakt shumë optimist nuk jam, se pavarësisht faktit se gjendja ime personale është më mirë, por problemet që ka bota janë shumë, shumë të rënda. Dhe sigurisht nuk kam shumë shpresë, por ja tani çdo njeri mundohet të mbajë veten dhe

të vazhdojë rrugën e vet.

- Mes talentit dhe punës, cila është përsosore?

Talenti është një e dhënë që të vendos në një shkallë fillestare mbase më e lartë se ç'është dikush tjetër, por përsëri duhet ta kemi të qartë se në botën e profesionistëve ka pothuajse vetëm njerëz të talentuar. Kështu që pak a shumë të gjithë kanë një dozë talenti të ngjashme, ajo çka i bën të ndryshëm janë dy gjëra: është puna sigurisht edhe pastaj diku vlera e tyre shpirtërore që ndihet në muzikë. Kështu që këtu dy gjëra bëjnë që dikush të bëhet një interpretues më i thellë, një lloj si kompozitorët. Pse Bethoveni është bërë Bethoveni? Ka kompozitorë të tjerë që 14 vjeç shkruanin kryevepra, ishin shumë të talentuar, por që më vonë janë bërë kompozitorë të Hollivudit edhe për muzika filmash, gjë që është shumë e respektueshme gjithashtu, por Bethoveni ka pasur për shembull një kërkesë ndaj vetvetes.

- Ju vazhdoni regjimin e rreptë të studimeve e provave si zakonisht?

Po, sepse unë nuk di të jetoj ndryshe, sido që të jetë puna. Do të doja ta lehtësoja veten ndonjëherë, sepse sigurisht jeta bëhet e vështirë kur ke kaq shumë kërkesa, por nga ana tjetër e kam të vështirë, sepse është personaliteti im, që është brumosur në këtë mënyrë dhe është pak vështirë që të ndryshoj. Po ja, duhen edhe momente që të stakojmë dhe të marrim pak pushim.

- Keni pasur një problem me dorën, e keni kaluar?

E kam kaluar, më mbetet akoma një lloj ndjenje pasigurie ndonjëherë, duhet akoma kohë që në mendje të mos e kesh.

- E përjetuat keq?

Ka ndodhur një herë, dy herë në koncert dhe ajo më bëri që ta ndaloja aktivitetin si koncertit, sepse kur nuk arrija të luaja me mundësitë e mia. Është torturë në fakt dhe aty arrija ta kuptoj sesi një gjë kaq e bukur si muzika mund të kthehet në një gjë kaq të hidhur

dhe shumë, shumë të rëndë. Dhe kjo më bëri shumë fatkeq, sepse zakonisht kam pasur në jetën time shumë probleme. Kam pasur drama, por muzika, violina më ka mbajtur gjithmonë dhe nuk prekej nga ajo që ishte jashtë saj. Ndërsa kësaj radhe ishte violina që ishte e prekur dhe nuk mund të më sillte më ngushëllimin e mëparshëm.

- Si ndihesh me spektatorin në



Tiranë? Ndodh që të duartrokasin e bëhesh pak nervoz?

Në Paris kam kërkuar që të duartrokasin midis kohëve në Filarmoninë e Parisit, sepse ka një pjesë-marrje të publikut që nuk i njeh veprat. Por, gjithsesi nuk e njoh publikun shqiptar, atë që vjen të më ndjekë mua, ndonjëherë janë të pakultivuar, ndonjëherë ndiej një lloj përqendrimit të veçantë, sepse deri diku më njohin më mirë. Kanë të paktën një ide të jetës sime, të etapave të saj.

-Dhe të admirojnë në Shqipëri, apo jo?

Po, është e vërtetë. E ndiej këtë dhe kjo më prek dhe më frymëzon jashtëzakonisht. Të paktën në kujtimet e mia kur luajta në "Partitura e Bahut" që është një program i vështirë në të gjitha vendet e botës dhe publiku ishte shumë i përqendruar, shumë i dëgjueshëm, nuk

lëvizte gjë në sallë. Nuk lëvizte gjë në sallë dhe më erdhi shumë mirë. Sepse unë mundohem ta luaj këtë në shumë vende të botës, por nuk janë gjithmonë organizuesit që e ndiejnë veten gatë për një repertor të tillë. Ndërsa këtu falë faktit që më njohin shkojnë më lehtë drejt një repertori që edhe pse mbahet në botë si i komplikuar e ndiejnë, sepse në fund të fundit për mendimin tim nuk ka repertorë të komplikuar në qoftë se interpretimi është ai që duhet. Duhet një minimum konditash sigurisht. Duhet një sallë që tingëllon, duhet një interpretues që ka punuar, që i ndjen gjërat. Aty pastaj mesazhi gjithmonë kalon çfarë do publiku të jetë se nuk besoj se duhet gjithmonë një përgatitje intelektuale për të shijuar muzikën. Është tepër e vështirë.

-Këtu je shumë i thjeshtë në skenë je shumë ëndërrimtar, me sy mbyllur luan gjithmonë...


Në fakt, më kalojnë në mendje lloj-lloj gjërash, por sigurisht shumica janë të lidhura me veprën, pastaj ka dhe shumë gjëra të tjera. Sigurisht që jam në një lloj bote, por përsëri e ndiej publikun, i ndiej reagimet, çfarë nuk më kalon në kokë në fakt, kështu që s'mund të them se jam dhe kaq i përqendruar, por rëndësi ka puna që është bërë dhe secili muzikant ka stilin e vet. Ka edhe muzikantë që janë të fokusuar në mënyrë të veçantë me muzikën. Unë mbase dukem i tillë, por nuk është kështu. Por kjo më ndihmon pak a shumë edhe për të shprehur kompozitorin.

-Ke pasur një eksplorim tani drejt Bethovenit?

Në violinë nuk jemi kaq të specializuar sesa në piano. Pianistët kanë një repertor edhe më të gjerë. Kemi bërë një disk, pas dy vitesh është përvjetori i datëlindjes së Bethovenit edhe kështu që do të luajmë shpesh këtë repertor. Plus që kemi projekt që të regjistrojmë dhe triote e tij. Kështu që mbetet diçka konstante për mua, Bethoveni, Bah...

-Po Paganini si të rri?

Paganini më pak. Sigurisht që ka qenë shumë i rëndësishëm në fillimet e mia dhe mbetet, por nuk është muzika e më tërëllë që mund të interpretoj. Teknikisht është revolucionar, ka muzikalisht mrekullira, por Bethoveni është në këta kompozitorë të paktë që kalojnë vërtetë në filozofik. Kështu që është më ngushëllues për një artist që ta interpretojë sesa Paganini sigurisht.



rindërtimin e bibliotekës albanobalkanologjike "Af Zef Valentini S.J. të Institutit të Studimeve të Larta të Filozofisë e Toeologjisë pranë Seminarit Ndërdioqezan Shqiptar në Shkodër.

Ishte mbajtës i tri dekoratave: Medalja "Naim Frashëri" për meritat e punës në fushën e bibliotekave (1987); 2. Kalorës i Kryqit të Madh të Urdhrit të Shën Gregorit të Madh të cilin ia ka dhënë më 1995 Shejtieria e Tij Papa Gjon Pali II, mbas dy vitesh veprimtarie diplomatike. 3. Kalorës i Urdhrit të Hyllit të Solidaritetit Italian dhënë prej Presidentit të Republikës s'Italisë Carlo Azeglio Ciampi (2005). WILLY GJON KAMSI, vdiq në Shkodër më mesnatën e 24 janarit 2017, kur sapo kishte mbushë 90 vjet jetë.

Projekti, një kompani indiane dhe 2 shqiptare kanë kërkuar së bashku të marrin koncesionin

Tiranë-Durrës, tarifë 2 euro për çdo kalim

Firma private premtan të ndërtojë rrugën paralele Tiranë-Plepa

Edhe pse Ministria e Infrastrukturës nuk ka pranuar ta bëjë publike ofertën për koncesionin e rrugës Tiranë-Durrës, Top Channel ka arritur të sigurojë disa nga detajet më të rëndësishme të saj.

Burime konfidenciale thonë se ofertuesi është një grup i madh indian me disa koncesione autostradash në Azi, por që në Shqipëri është i përfaqësuar nga dy kompani lokale, Albstar, e cila po ndërton stadiumin Arena kombëtare si dhe kompania Trema Inxhiniering.

Por si do të preken qytetarët nga dhënia me koncesion e kësaj rrugë? Studimi i fizibilitetit, që edhe ky nuk është bërë publik nga qeveria, parashikon dy tarifa.

Për automjetet e vogla do të paguhet 2 euro për çdo kalim, ndërsa për automjetet e mëdha tarifa do të jetë 5 euro.



Projekti për dhënie me koncesion të rrugës Tiranë-Durrës parashikon që kompania private të zgjerojë me dy korsi të tjera rrugën kryesore si dhe do të sigurojë rrugë alternative kalimi pa pagesë.

Bëhet fjalë për rrugën e vjetër Tiranë-Ndroq-Plepa,

e cila do të rikonstruohet po nga kompania private.

Në projektbuxhetin e vitit 2019, qeveria ka vënë si vlerë tavan për këtë koncesion shifrën 49.1 miliardë lekë ose rreth 380 milionë euro.

Dhënia me koncesion e rrugës Tiranë-Durrës është

QENDRIMI I MINISTRISË

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë po analizon propozimet, nuk ka asnjë vendimmarrje dhe në rast të një konkluzioni pozitiv, do të ndiqen me transparencë të plotë të gjitha procedurat e përcaktuara në ligj.

tohen përfundimisht vetëm nëse Ministria e Transporteve vendos ta pranojë ofertën e koncesionit.

SQARIMI I MINISTRISË

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë informon opinionin publik se në këtë institucion është depozituar një propozim nga një subjekt privat për realizimin e projektit të zbatimit, financimit, zhvillimi dhe operimit e projektit sipas kornizës së PPP në modelin BOT, për segmentin rrugor:

Segmenti 1: Tiranë-Vorë-Durrës

Segmenti 2: Kashar-Rrogozhinë

Propozimi ka për qëllim të ofrojë një zgjidhje të qëndrueshme për të ulur ngarkesën në të gjithë rajonin Tiranë, Durrës dhe Rrogozhinë.

Skema e propozuar parashikon ndërtimin e veprave në fjalë në dy faza. Së

pari, zgjerimin e aksit Tiranë-Vorë-Durrës, rehabilitimin e rrugës dytësore Tiranë-Durrës përmes Ndroqit dhe vendos të aksesit për bizneset. Së dyti, në një fazë të mëvonshme, përtej 2025, parashikohet ndërtimi i aksit tjetër Kashar-Rrogozhinë.

Skema e propozuar parashikon që të gjithë koston e ndërtimit e përballon koncesionari privat, i cili vendos një tarifë për kalimin duke garantuar shlyerjen e investimit dhe fitimin e arsyeshëm pa rënduar mbi Buxhetin e Shtetit. Qytetarëve u krijohet edhe mundësia e kalimit pa pagesë përmes rrugës alternative.

Projektet e paraqitura kanë për referencë kosto tavan dhe jo kosto konkrete të realizimit. Kostot finale të projekteve përcaktohen vetëm pasi të ketë projekt zbatimi të miratuar për realizimin e veprave në fjalë.

Pedagogë! E ardhmja nis në klasën tuaj.

Shëndeti juaj sigurohet me Cash Plan-in tonë!

Të gjitha përfitimet në një zgjidhje, me sigurimin Jetë dhe Shëndet Cash Plan! Siguroni veten dhe familjen tuaj, duke filluar nga 85 euro në vit/person dhe përfitoni mbulim për ndërhyrje kirurgjikale, vizita, analiza, medikamente, etj. deri në 25,000 Euro/vit.

- Sigurim Jete
- Checkup mjekësor vjetor
- Mbulim të shpenzimeve shëndetësore
- Zbritje deri në 60% në spitalet dhe klinikat private pjesë të rrjetit mjekësor SiCRED

**SIGURIMI
JETË dhe SHËNDET
CASH PLAN**

SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete

Për të blerë policën, kontaktoni me SiCRED në: **Tel: +355 4 22 37 549 | Cel: +355 69 20 84 026 | e-mail: shitje@sicred.com.al**



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 634

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHOIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 3 Nëntor 2018

RUDINA DEMBAÇAJ: JU RREFEJ ENDRREN TIME ME TE HERSHME

*Flet autorja e "Mos i fol shoferit":
Kam pasur kritika lidhur me një monolog.
Jam çdo ditë në përmirësim të vetvetes*



DEBATI

E OFENDOI ME
FJALE TE PISTA,
REAGON MENAXHERI
I LEDRI VULES:
S'IA VLEN MERRSH ME TE VEGJEL



HALLOWEEN

TE FRIKSHME DHE SEKSI/
MASKAT E VIP-ave



E pyesin për praninë e fëmijëve të Shkëlzenit në dasmë, habit Armina me përgjigjen

Armina Mevlani është një nga bloggeret më të njohura shqiptare. Jeta private e Armina Mevlanit gjerësisht është përfolur në median rozë, kjo për shkak se është e lidhur me djalin e ish-kryeministrit Sali Berisha si dhe për faktin se ai ka dhe dy fëmijë të tjerë nga martesja e parë. Shpesh pyetjet e fansave adresohen në lidhje me marrëdhënien e Arminës me fëmijët e partnerit të saj, Shkëlzen Berishës. 'Kur të martohesh a do i ftoh fëmijët e Zenit në dasmë?' ka pyetur një prej tyre. 'Sigurisht, unë i dua shumë ata' është shprehur Armina në postimin e saj në 'Instagram'. Vetëm para pak javësh çifti ka organizuar një ceremoni madhështore për fejesën e tyre. Nuk dihet nëse në këtë ceremoni private ishin



të pranishëm dhe dy fëmijët e Zenit, ndërkohë që shoqëroheshin nga Sali Berisha dhe bashkëshortja e tij Liri Berisha. Të shohim si do të jetë e veshur nuse bloggerja bukursohe.

Dona i përket historisë, Musa i 'Big Brother' prezanton "femrën e tij"

Ata ishin një ndër çiftet më të pëlqyer që u krijuan në edicionin e fundit të "Big Brother"9. Dona dhe Musa kaluan një periudhë shumë të bukur brenda në shtëpinë më të famshme që na bëri të mendonim se do të kishin një të ardhme bashkë, por s'ndodhi kështu. Si disa çifte të tjerë, Musa dhe Dona u ndanë pak kohë pas përfundimit të spektaklit. Menjëherë pasi dolën nga 'reality show' Musa u largua për në Itali dhe vazhdoi jetën aty ku e kishte lënë. Dhe mesa duket ai ka nisur edhe një marrëdhënie të re atje. Kjo u bë edhe më e besueshme nëpërmjet një postimi të bërë së fundmi në 'Instagram' ku ai na prezanton të dashurën e re. Pa zbuluar shumë detaje rreth saj, Musa dhe vajza në foto, shfaqen shumë pranë njëri-tjetrit. Në mbishkrimin e fotos ai shkruan "Lady", duke bërë të besojmë se është më tepër se shoqe. Shpesh Musa është përfolur për një lidhje të re, dhe tani ishte vetë ai që i dha përgjigje këtyre thashethemeve.



Paska qenë i martuar e me fëmijë, ja e shkuara e burrit miliarder të Angelas Martinit

Modelja e njohur Angela Martini publikoi në profilin e saj në 'Instagram' disa foto nga festa madhështore e ditëlindjes që kishte organizuar për bashkëshortin, miliarderin rumun Dragos Savulescu. Por vëmendjen e publikut e tërhoqi jo vetëm Angela me fustanin e bardhë super seksi, gjë që pritej, atmosfera luksoze që e rrethonte etj., por diçka tjetër tërhoqi vëmendjen. Në njërin prej pozave, në praninë e Angelës dhe Dragos shfaqet një vajzë e vogël, e cila sipas 'Iconstyle', në fakt, është një fëmijë nga martesja e mëparshme e Dragos. Ai ka qenë i martuar në vitin 2005 me stomatologjen Rodica Ghionea, martesë prej së cilës patën së bashku një vajzë. 4 vjet pas dasmës, çifti i dha fund martesës. Pas divorcit, ai u lidh me modelen seksi Madalina Ghenea, por në 2011-ën ajo i dha fund lidhjes me rumunin. Pas saj, Dragos u martua me modelen shqiptare Angela Martini në një ceremoni pa bujë dhe tashmë jetojnë së bashku në Los Angeles. Por, pavarësisht të shkuarës, bashkëshorti i Angelës i mban kontaktet me fëmijën nga martesja e parë.



Më krenarë se kurrë! Dua Lipa poston videoklipin e bashkëpunimit me Andrea Bocellin

Pas sukseseve të një pas njëshme, ajo që na ngrohi akoma më tepër zemrat ishte bashkëpunimi i fundit me këngëtarin e famshëm Andrea Bocelli. Kënga e tyre 'If Only' është publikuar tashmë me videoklip. Ka qenë këngëtarin i madh italian, Andrea Bocelli ka vendosur të publikojë me videoklip këngën me Dua Lipën. Balada e bukur, e cila është pritur shumë mirë nga publiku, tashmë është një singël zyrtar nga albumi më i ri i këngëtarit legjendar. Zëri i Duas është lavdëruar tej mase në këtë këngë, ndërsa për këngëtarin shqiptarë ky është padyshim bashkëpunimi më i rëndësishëm që ka bërë deri tani në karrierën e saj. "If Only", sa shumë emocion brenda një kënge!



Nga një zombie si Genta Ismaili e deri te një lepurushe seksi si Armina Mevlani, ja fytyrat më të pabesueshme të njerëzve të njohur

Të frikshme dhe seksi/ VIP-at vishen për Halloween

Të frikshëm, por edhe seksi. Kjo festë ishte një mënyrë tjetër për të sjellë një arsye më tepër që njerëzit të festonin dhe jo vetëm. Prej vitesh, festa e Halloween-it po festohet çdo vit e më bukur edhe në Shqipëri. Nuk ia priste mendja shumë prej nesh se VIP-at tanë do t'i bashkoheshin seriozisht kësaj feste. Por mesa duket shumica e tyre, përfshirë këtu sidomos bukuroshet me një pamje provokuese, kanë ndarë

Pamela Aliaj

nëpër rrjetet sociale fytyrën e tyre për Halloween. Edhe pse në thelb, koncepti i kësaj feste është maskimi me një pamje të frikshme dhe jo vetëm. Halloween quhet ndryshe si festa e të vdekurve ku njerëzit e gjallë festojnë për të përkujtuar ata që s'janë më duke u maskuar si të vdekur për t'u përshtatur më

tepër me atmosferën. Ideja e maskimit është të shfaqesh me një fytyrë zombi apo vampiri apo edhe më keq, por duke parë maskimet e këtij viti të vip-ave tanë mund të themi se shumica prej tyre ja kanë dalë mëse mirë për të sjellë këtë frymë në kryeqytet e kudo ku kanë festuar. Ndër to do të sjellim disa që kemi veçuar si më të veçantat të realizuara këtë vit. Kush nga këto mendoni se meriton vendin e parë?



Rita Ora
(shtrigë)



Eneda Tarifa
(shtrigë)



Tayna
(Lady Gaga)




Tuna (shtrigë)



Roza Lati (zombie)



Armina Mevlani
(lepurushe)



Rike Roçi
(shtrigë)



Zaimina Vasjari
(zombie)



Genta Ismaili
(zombie)



Emina Cunmulaj
me vajzat (tri Hürushe)



Flet autorja e “Mos i fol shoferit”: Kam pasur kritika lidhur me një monolog

Rudina Dembacaj:

Ju rrëfej ëndrrën time më të hershme

“Jam çdo ditë në përmirësim të vetvetes”

Kjo vjeshtë solli në ekranet e mediave një sërë risish në programacion. Shumë emisione apo show u perfeksionuan, shumë të tjerë u mbyllën dhe të tjerë e hapën siparin me nisjen e sezonit të ri televiziv. Padyshim që emisionet e ndryshme si investigative, informative, apo edhe show-t kanë audiencën e tyre, por ajo që mund të theksojmë është se këta të fundit janë më të parapëlqyer për shqiptarët. Larg politikës dhe zhurmave të kronikës së zezë, show-t humoristike dhe argëtues zënë një pjesë të konsiderueshme në media, përfshirë edhe ato të formatit informativ. Një ndër to është edhe “Mos i fol shoferit” i Rudina Dembacaj. Duket se aktorja pas formatit të vjetër solli një tjetër risi në ekranet shqiptare me një format krejt të sajën duke e bërë atë femrën e parë që drejton një show humoristik në vend. Në një intervistë ekskluzive për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare”, Rudina ka folur për prapaskenat e formatit të ri. Në çdo nismë ka dhe kritika dhe mendime të dyta lidhur me formatin dhe Rudina na shpreh pikërisht anët e pashprehura të



emisionit të saj. Ëndrra e saj më e madhe, përkushtimi, frymëzimi, por edhe kritikak që ka marrë me show-n e ri i zbuloni në intervistën e mëposhtme.

Pamela Aliaj

Prej pak kohësh keni nisur me formatin e ri të “Mos i fol shoferit”. Si lindi ideja dhe pasurimi i këtij show?

Është vetëm fillimi i ëndrrës sime të hershme! Që në fillimet e mija si aktore, ëndrra ka qenë të kem show-n tim.

A keni pasur ndonjë frymëzim ku jeni mbështetur për të nisur këtë format të ri?

Absolutisht nuk është parë askund. Kam pasur ndihmën e madhe nga Ina Gjonci për përbërjen dhe Enkel Gurakuqi për detajet e stu-



dios, xhirimit etj., të cilët i falënderoj shumë.

Shpesh në statutet tuaja në 'Instagram' shihet dhe shprehja "Mos i fol Rudit". A e keni menduar si më të përshtatshme si emër për emisionin tuaj?

Është tendencë, në fakt. Më pëlqen, por është thjesht një hashtag.


Si u prit ky ndryshim i formatit?

Deri tani është pritur vërtetë shumë mirë. Kam akoma punë përpara sigurisht, por faleminderit stafit tim dhe tv Ora News!

Patët ndonjë projekt tjetër në mendje, por më vonë i mëshuat këtij? Pse?

Gjithmonë këtij. Sepse e dashuroja që para se të lindte.

Nga makina në skenë. Duket se Rudina është më



e lidhur me publikun live. A keni menduar ta pasuroni më tepër me aktorë të tjerë skenën, siç bëtë me Ana Likën?

Mendoj pa fund si të perfeksionoj këtë produkt. Të gjithë janë pasuri për mua.

Duket se e dashuroni këtë profesion, por jashtë skenës dhe syve të publikut kush është Rudina në jetën e përditshme?

Hmmmm.. duhet të pyesni të tjerët. Mendoj se jam çdo ditë në përmirësim të vetes.

Viktorja është padyshim lumturia juaj e parë si

nënë. A keni menduar për ndonjë vëlla apo motër për vogëlushen?

Është shumë shpejt!

A jeni duke u marrë me ndonjë projekt tjetër përveç angazhimeve në teatër dhe show-t tek Ora News?

Janë mjaftueshëm për të ma zënë ditën. Viktorja e ka kohën të paprekshme.

A keni patur ndonjë reagim negativ lidhur me ndonjë temë të prekur te puntatat? Si keni reaguat?

Kam pasur disa komente për një pjesë të një monologu. I kam marrë si këshilla. Përpiqem t'i marr parasys.

A ju vijnë propozime në inbox lidhur me temat që mund të diskutoni? Keni menduar t'i pranoni apo dhe t'i vini në skenë?

Po, me shumë kënaqësi, janë një ndihmë madje!

Cila është e veçanta sipas Rudinës e të drejtuarit një show-t nga një femër?

Nuk ka lidhje nëse është femër apo mashkull. Nëse show është interesant dhe ka çfarë i jep publikut, e ka të veçantën.





Përveç meje kush ka rënë tjetër në pusëtë? Pres përgjigje serioze, Tim.

“Përveç meje kush ka rënë tjetër në pusëtë?” Aksidentohet rëndë aktorja shqiptare

Ajo është një nga aktoret më të talentuara dhe të dashura për publikun. Shpesh nëpër rrjetet sociale shpërndan copëza nga jeta e saj. Por postimi i fundit i saj bëri vërtet përshtypje. Për fat të keq Olta Daku pësoi një goxha incident. Me anën e një fotoje ka njoftuar se ka rënë në pusëtë. Këtë njoftim e ka shoqëruar me këmbën e saj të nxirrë si mos më keq. ‘Përveç meje kush ka rënë tjetër në pusëtë? Pres përgjigje serioze.FLM’ shkruan aktorja në postimin e saj. Si vend pa kapakë pusëtash, aktorja duhet të ketë më kujdes herës tjetër!

Eni Shehu thumbon Nevina Shtyllën: Uroj të gjejë veten në emisionin që dikur përçmonte

Moderatorja simpatike, Nevina Shtylla prezantoi për një sezon në “Klan” emisionin “Jo vetëm modë”. Në këtë program ajo bashkëpunonte me Eni Shehun, i cili ishte në rolin e kryeredaktorit. Por duket se pas largimit të bujshëm të Nevinës nga “Klan” drejt “Top Channel” janë prishur marrëdhëniet mes tyre dhe këtë e ka treguar për herë të parë Nevina në “Pop Culture”. Ajo tregoi hapur se Eni e ka bërë bllok në rrjetet sociale. Menjëherë pas deklaratës së moderatores, ka ardhur edhe reagimi i Enit, i cili në një prononcim për “Anabel.al” ka treguar se me Nevinën nuk kanë pasur asnjëherë marrëdhënie shoqërore. E vetmja gjë që i lidhte ishte puna. I pyetur lidhur me bllokimin në rrjetet sociale, ai ka treguar duke qeshur se mund ta ketë shtypur pa dashje. “Mesa duket i mungoj ‘profesionalisht’. Uroj të gjejë veten në programin e ri të sportit



që mesa kujtoj e ka përçmuar”, shprehet gazetari. Kujtojmë se pak muaj më parë Nevina ka treguar në “Pop Culture” se nuk është e prirur ndaj futbollit dhe për të një rol i tillë do të ishte një sfidë shumë e madhe. Pse gjithë këto thumba mes kolegësh? Ç’të ketë ndodhur? Të presim reagimin e bukurshes.

Nuk gjen rehat Luana Vjollca! Ja ndryshimi i radhës

Para disa javësh moderatorja Luana Vjollca vendosi të rikthehej në formën e saj natyrale. U paraqit për festën e njohur të Halloween me flokët brune. Vërtet që nuk ishim mësuar me këtë pamje të saj. Edhe pse të gjithë fansat e mirëpritën këtë ndryshim, bukurshja tregoi se nuk ishte aspak pro këtij look-u kështu që nuk priti as të kalonte as një muaj para se të rikthehej në pamjen e saj të përditshme, një bionde eksplozive.



Kujt ia priste mendja! Këngëtarja shqiptare është në pritje të ëmbël prej tetë muajsh

Këngëtarja e njohur e muzikës popullore ka zgjedhur së fundmi të mos jetë shumë aktive në media dhe nëpër evente dhe tashmë e kuptuam arsyen. Prej tetë muajsh Maya ia ka dalë ta mbajë shumë sekret priten e ëmbël. Por ‘sekreti’ i saj u zbulua në një nga emisionet e pasdites ku prezantuesja e “Inlife”, Megi Bilo, tha se këngëtarja Maya është shtatzënë. Gjithashtu, është mësuar se këngëtarja do të bëhet nënë e një djali. Tre muaj më parë, ajo publikoi këngën “Kënga jonë”, në bashkëpunim me këngëtares Fatmira Breçani. Edhe gjatë klipit, këngëtarja ishte kujdesur të vishte fustane të gjëra, duke fshehur barkun e rrumbullakosur. Këngëtarja ka lidhur kurorë prej disa vitesh me Benin, i cili është me profesion arkitekt. Urime çifit!



Agon Amiga e akuzoi për fshirjen e këngës, flet Faton Shoshi: Ja si qëndron e vërteta

E ofendoi me fjalë të pista, reagon menaxheri i Ledri Vulës: S'ia vlen të merresh me 'të vegjël'

Pamela Aliaj

Prej kohësh dihej se marrëdhëniet mes reperëve kosovarë nuk janë aspak të mira dhe kjo për shkak të miqësive që kanë apo grupeve tek të cilat ata bëjnë pjesë. Këta javë ajo që bëri përshtypje ishte shpërthimi i një lufte virtuale midis reperëve në 'Instagram'. Ndërsa ditë më parë reperi Lumi B me deklaratën e tij thumboi Agon Amigën, ky i fundit nuk u mjaftua dhe përveç se iu kthye atij, e kapi edhe me mikun e ngushtë të reperit, Ledri Vulën në këngën e re "Qy qysh".

Amiga thotë në këngën e re:

Unë s'po shoh Vulë, unë po shoh kurvë, unë po shoh gay".

Me sa duket përgjigja e reperit ka qenë e shpejtë pasi ka akuzuar dikë në një postim të ri të bërë në 'Instagram' ku thotë se i kanë fshirë këngën që ai ka postuar, por jo historinë. Sërisht ai reagon për një situatë të tillë.

Amiga shkruan:

"Mund që të gjitha këngët të m'i fshish nga Youtube, por historinë time kurrë s'mundesh ta fshish".

Nuk dihet nëse këto akuzat i drejtohen Ledrit apo shokut të tij, Lumi B. Ndërkaq nga ana tjetër për të kuptuar më mirë lidhur me këtë situatë, menaxheri i

"Së shpejti do të ketë një bashkëpunim në Los Angeles"



Ledri Vulës, Faton Shoshi ka folur për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare". Shoshi ka thënë se nuk ka për të pasur reagime dhe se nuk ia vlen të kesh të tillat me persona të tillë 'të vegjël', siç e quan ai

Amigën. Për sa i përket këngës së fshirë të reperit, Shoshi ka thënë se nuk ka asnjë informacion, ndërsa lidhur me marrëdhënien e Ledrit me Amigën: Kanë marrëdhënie të mira e korrekte. Ledri nuk ka pasur

asnjë konflikt me ta. Ndërkaq i pyetur për projektet e reja të reperit, menaxheri i Ledrit është shprehur:

"Tani do të dalë kënga me Gashin, për disa ditë. Ende s'kemi caktuar datën". Ndërsa në fillim të vitit 2019,



Ledri do të niset në Los Angeles ku shumë shpejt do të sjellë një bashkëpunim të ri."

Pra, të tjera surpriza rezervon reperi kosovar, ndërsa lidhur me fjalët e Amigës as që kanë ndërmend të reagojnë. Pra, shumë zhurmë për asgjë! Urojmë të përfundojë me kaq "lufta në Instagram".

Dje në "Zëri i Amerikës"

Ballkani dhe hija e Luftës I Botërore

(vijon nga faqja 1)

...përgjaksme që ka njohur njerëzimi dhe që la gjurmë të thella në peizazhin gjeopolitik të globit për dekada me radhë. Kolegia Ardita Dunellari bisedoi me dy historianë mbi trashëgiminë kryesore të këtij konfliktit në zhvillimet e sotme ballkanike:

Kanë kaluar 100 vjet që nga përfundimi i Luftës I Botërore, por gjurmët e saj kanë vazhduar të ndjehen në botë për thuajse një shekull. Kaosi dhe shkatërrimi i paskonfliktit krijuan terren për ideologji të ekstremitetit që diktuan zhvillimet politike në një pjesë të madhe të globit për dekada me radhë:

"Pa Luftën e Parë Botërore vështirë të imagjinohet një lëvizje radikale revolucionare si ajo e Leninit që mori pushtetin në Rusi, e që u bë faktor kyç në përhapjen e ideologjisë komuniste si alternative funksionale. Dhe në skajin tjetër të spektrit - nazizmi dhe fashizmi, vështirë të imagjinohet që këto ideologji të skajshme do të bëheshin faktorë qendrorë në Evropë dhe në historinë globale, pa Luftën e Parë Botërore," thotë Aviel Roshwald, profesor i historisë në Universitetin "Georgetown" në Uashington.

Lufta I Botërore la pas perandori të shpërbëra, ekonomi të shkatërruara, miliona të vrarë, të plagosur e të zhvendosur që u bënë burim i radikalizimit të shoqërive të prekura nga konflikti, shpjegon historiani Aviel Roshwald.

"Menjëherë pas luftës, në 1918-1919 u duk sikur ithtarët e idealit të vetëvendosjes për kombet e vogla të Evropës dolën fitimtarë, pasi perandoritë shumetnike si Perandoria Austriake, Romanovët në Rusi, Perandoria Osmane në Lindjen e Mesme u shpërbënë dhe u lanë vend shteteve të reja. Por secili nga këto shtete i dalë nga hiri i perandorive të shpërbëra lindi në kaos, në sisteme ekonomike të ndërprera, nga shkatërrimi i luftës".

John Lampe, njohës i zhvillimeve ballkanike, thotë se njësitë e reja që u krijuan në Ballkan, rezultante të marrëveshjeve arbitrare mes fuqive botërore, me popullsitë e përziera etnike dhe pretendimet për zgjerim territorial u bënë burim abuzimesh, masakrash, përndjekjesh të ndërsjella mes kombeve ballkanike. Jehona e atyre ditëve ndjehet



ende sot në zhvillimet politike në rajon:

"Këto kujtime nga koha e luftës... ky sfond i asaj periudhe ndihmon për të kuptuar sa e vështirë është tani të gjendet një zgjidhje për kufirin mes Serbisë dhe Kosovës".

Ideali që prezantoi Lufta e

Parë Botërore - e drejta e kombeve për vetëvendosje - është përfolur e analizuar shumë në 100 vjetët e fundit. Profesor Lampe thotë se vetëvendosja në praktikë nuk ofron gjithmonë zgjidhje të qëndrueshme të pretendimeve territoriale:

"Nëse me vetëvendosje nënk-

uptojmë një qeveri kushtetuese që u ofron të gjithë qytetarëve një shans për votë, dakord. Por, nëse me këtë shprehje nënkuptojmë vetëvendosje vetëm për një grup etnik, është e qartë që nuk shërben për zgjidhje të suksesshme".

Profesor Roshwald thotë se

historia e njerëzimit ka dëshmuar se kur vetëvendosja rezultoi në ndryshim kufijsh, dalin më shumë probleme të reja se sa zgjidhen. Në rastin e Kosovës dhe Serbisë, thotë ai, zgjidhja e vetme funksionale mund të gjendet tek marrëveshja mes palëve:

"Në shumë, shumë raste, ndryshimi i kufijve krijon burime të reja për hakmarrje dhe pretendime irredentiste vite më pas. Me rëndësi kyçe për Kosovën dhe Serbinë është gjetja e një zgjidhjeje që pranohet nga të dyja palët dhe jo që imponohet nga njëra palë".

Profesor Lampe thotë se problemi nuk qëndron tek kufiri aktual mes Kosovës dhe Serbisë, por tek gjurmët që ka lënë historia tek këto popullata, tek një mëri që mbartin dy kombet brenda vetes, të ushqyer në masë të madhe nga zhvillimet gjatë dhe pas Luftës I Botërore. Por ai sjell shembullin e Irlandës, për të dëshmuar se ka zgjidhje edhe për problemet e armiqësive të gjata mes popullatave, pa nevojën e ndryshimit të kufijve:

"Kërkohet një angazhim nga një numër kritik udhëheqësish si nga serbët ashtu edhe shqiptarët në Kosovë që të mbështesin një marrëveshje për t'i garantuar pjesëmarrje pakicës serbe. Edhe vetë pakica serbe duhet ta kuptojë se është në interesin e tyre të angazhohet, të marrë pjesë në parlamentin e Kosovës".

Perëndimi punoi shumë për të nxjerrë mësim nga dy luftërat botërore dhe për të vënë në funksionim garanci që konflikte të tilla shkatërrimtare nuk do të përsëriteshin, duke krijuar institucione transatlantike, pista shkëmbimesh për të rritur besimin e ndërsjellë dhe për të lehtësuar dialogun.

Fuqitë perëndimore, dikur armike në anë të kundërta të konfliktit, përqaftuan parimet e tolerancës, shtetit ligjor, kompromisit, të drejtat e komuniteteve, të gjitha të frymëzuara nga mësimet e nxjerra nga konfliktet, mësimet që Ballkani duket se nuk i ka përvetësuar ende 100 vjet pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore.



BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA



te rejat nga jefa ipave

çdo të shtunë falas me

Opinion i Ditës

Nasradin Hoxha në Bruksel

Nga Veton Surroi

(vijon nga faqja 1)

...Personi që dha këtë shpjegim ishte nga Zyra e komisarës për politikë të jashtme të BE-së, zonjës Mogherini. Personi që mori këtë shpjegim është nga bota e organizatave joqeveritare të specializuara për politikë të jashtme, dhe e deklaroi në një konferencë të mbajtur këtë javë në Bukuresht.

Ideja për të cilën bëhej fjalë ishte këmbimi i territoreve mes Kosovës dhe Serbisë, i quajtur edhe "korrigjim i kufijve" (Thaçi) apo "përkufizim mes shqiptarëve e serbëve" (Vuçiqi).

Deklarimi i këtillë ishte përshkrimi më i mirë i mundshëm i ndërmjetësimit të deritanishëm evropian për "normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës e Beogradit". Pas viteve të shpenzuara në ndërmjetësim për t'u dakorduar se targat e veturave të Serbisë e të Kosovës mund të mbulohej me letërngjitës në mënyrë që të qarkullojnë lirshëm (dhe kjo çështje ende nuk po aplikohet), diplomacia e Komisionit Evropian tregon se nuk ka më ide të ngjashme, dhe po e merr në konsideratë atë për të cilën dinë se është e keqe.

Dhe, me këtë, ndoshta jo në formë të vetëdijshme, kjo diplomaci vërteton se mënyra më e mirë për ta fshehur një problem është që të krijohet një më i madh. Apo, ndoshta, se mënyra më e mirë për ta fshehur dëshitim (në "normalizim") është që të krijohet një dëshitim më i madh (në "normalizim").

Argumenti, i cili është dëgjuar tashmë gjashtë muaj korridorëve të Brukselit, e tash edhe të Prishtinës e të Beogradit, është se Thaçi me Vuçiqin, megjë tashmë janë pak a shumë të pajtimit se si do të këmbejnë njerëz e territore, duhet ta arrijnë marrëveshjen sa më parë, para zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Rezultati i këtyre zgjedhjeve shpërfaqet si një gogol i madh, aq i madh madje sa me të po frikëson edhe Thaçi. Gogoli, i cili po qarkullon sot nëpër Evropë është populizmi, dhe sipas frikësuesve me këtë gogol, një Parlament Evropian që do të dominohej prej njerëzve të ngjashëm me kryeministrin hungarez, Orban, apo zëvendëskryeministrin italian, Salvini, do të ishte i dëmshëm për interesat e Kosovës. Rrjedhimisht, marrëveshja duhet të mbërrihet me këtë Parlament Evropian dhe me këtë Komision.

Por ky mandat i Parlamentit Evropian dhe i Komisionit nuk është se përmirësoi dukshëm marrëdhënien e Kosovës me BE-në. Nga perspektiva e një qytetari të rëndomtë do të shtrohet një pyetje e thjeshtë: a e solli ky Parlament dhe ky Komision liberalizimin e vizave? Përgjigja është dhe ka gjasa të mbetet negative. Nëse Parlamentin dhe Komisionin "populist" qenkan të këqij që tani, para se të zgjidhen, pse qenka i mirë ky Parlament dhe ky Komisioni "liberal"? Çështje e vërteta, përgjigja nuk



mund të jetë e thjeshtë, një ndihmesë e madhe iu dha vendit me Marrëveshjen e veçantë të Stabilizim-Asociimit, dhe që fryt i këtij Komisioni e Parlamenti. Por edhe kjo Marrëveshje u bë me një vend "jonormal", një vend që është ende në konflikt të papërfunduar me Serbinë e që zhvillohet në territor të vetin, rrjedhimisht, rezultatet nuk mund të jenë sikur të shtetet "normale".

Problemi qëndron tek Nasradin Hoxha. Apo të jem më preciz të ftesa që iu bë Nasradin Hoxhës në Bruksel, të Komisioni Evropian.

Qe ftuar një herë Nasradin Hoxha të ndajë drejtësi mes dy palëve dhe dëgjoji njerëz palë e i dha të drejtë, pastaj dëgjoji tjetërën dhe i dha të drejtë po ashtu. Dikush nga xhemati i mbledhur protestoi, duke e pyetur Hoxhë efendiun se si është e mundur që të dyja palët në konflikt të kenë të drejtë, dhe Nasradini iu përgjigj: "Edhe ti ke të drejtë". Komisioni Evropian deri më sot

ka deklaruar se Kosova ka të drejtë kur shpalli pavarësinë (23 vendet anëtare të saj) e po ashtu ka të drejtë Serbia që ia mohon Kosovës shtetësinë (pesë vendet anëtare të saj). Kur dikush nga jashtë pyet se si është e mundur një gjë e tillë, edhe atyre u thuhet se Komisioni ka të drejtë.

Drejtësinë e ndarë alla Nasradin diplomacia evropiane ia ka gjetur një emër (të huazuar nga H.Kissinger), "ambiguitet konstruktiv". Me të nuk zgjidhet ndonjë problem, por hapet disi një proces negociator, që shtyn gjërat deri sa të pihen rrethanat për t'i dhënë fund konfliktit.

Diplomacia e Komisionit Evropian, e udhëhequr nga parimet e Nasradin Hoxhës, tash është në fazën ku në mungesë të ideve brilante për mbulimin e targave të automjeteve me letërngjitës të provojë "një ide që e dimë se është e keqe". Prej "ambiguitetit konstruktiv", Komisioni po kalon drejt e në "nonsens konstruktiv", në ndërmarrje që "dimë

se është e keqe, por nuk kemi ide të tjera".

Ndoshta do t'ia vlen të Komisioni Evropian t'i shikojë Kosovën e Serbinë me dioptri evropiane, e jo nëpërmjet mësimeve të Nasradin Hoxhës.

I tërë ndërtimi monumental i integritimit evropian u bë në momentin kur në vend të idesë për këmbim popullatash, territoresh e luftash për resurse, tokë dhe popullata u adoptua ideja e bashkëpunimit mes popujve dhe shteteve që luftuan deri dje, me kufijtë e popullatave që u gjetën aty në fund të konfliktit të armatosur.

Dhe i tërë ky ndërtim monumental që i mundur ngase general amerikan George C. Marshall, në zyrën e të cilit prej sekretar shteti u ravijëzua projekti i madh i një Evrope të lirë e të sigurt, të integruar tej kufijve shtetërorë, nuk ftoi që drejtësinë për kombet e shtetet evropiane pas Luftës së Dytë Botërore ta ndajë Nasradin Hoxha.

Koha.net

HOROSKOPI

DASHI

Në raportet e dashurisë mund të hidhni një hap të gabuar, prandaj kujdes. Në punë sot yjet do të jenë me ju, prandaj pritë të kaloni një ditë përgjithësisht të mirë.

DEMI

Nëse jeni në një lidhje, duhet të tregoheni më tolerant ndaj partnerit tuaj. Me financa po kaloni një moment të mirë, prandaj mund të bëni blerje që i keni pasur në mendje.

BINJAKET

Lëreni mënjane stresin duke ushtruar frymëmarrjen. Joga, meditari apo prania juaj në një objekt fetar do të ishte një opsion optimal për të larguar energjinë negative që keni përreth prej disa ditësh.

GAFORJA

Parashikohet një ditë e mbarë dhe me fat në dashuri. Nëse jeni i paangazhuar në këtë drejtim, mund të krijoni një raport të ri. Sharmi nuk do ju mungojë për të bërë për vete partnerin.

LUANI

Parashikohet një ditë pa impenjime. Mund të qëndroni në ambientet e shtëpisë për t'u qetësuar. Në aspektin e financave mund të merrni një shumë të mirë parash.

VIRGJERESHA

Për disa momente do t'i harroni vështirësitë në punë falë një takimi me një mik të mirë. Përgjithësisht dita do të jetë e mbarë si në fushën e financave, ashtu edhe në dashuri.

PESHORJA

Përpara se të ndërmerrni një vendim rreth punës tuaj, do të ishte mirë që këshilloheni me një person me eksperiencë. Pengesat do t'i kaloni falë inteligjencës dhe bashkëpunimit.

AKREPI

Në fushën profesionale keni nevojë për një ndryshim qoftë në ambient, por edhe në eksperiencë. Mos hezitoni, nëse dëshira e brendshme ju kërkoi këtë.

SHIGJETARI

Mund të jetë një ditë pak e lodhshme kjo e sotmja. Merrni me qetësi, sepse vetëm këshuta do e kaloni mirë. Ndjëni mungesën e një personi, i cili së shpejti do të jetë pranë jush.

BRICJAPI

Mund të përfshihen në një debat me partnerin. Tërhiquni në momentin e duhur, pasi mund të shkatërroni një raport. Në vendin e punës dikush mund të përhapë thashetheme për ju.

UJORI

Tregoni kujdes sa i përket shpenzimit të parave. Yjet nuk ju favorizojnë në këto çaste me financa. Për rrjedhojë, edhe daljet me miqtë mund t'i keni të kufizuara.

PESHQIT

Aspekti planetar ju bën sot shumë pasionant. Një njoftje e re duket në sfond dhe gjërat në këtë raport mund t'ju ecin mbarë. Me pak fat mund të nisë një marrëdhënie e lumtur për ju.

Trajneri i Partizanit sulmon FSHF-në pas dënimit

Pas humbjes në shtëpi ndaj Skënderbeut, Partizani ka një tjetër takim delikat ndaj Kamzës. Në prag të këtij takimi, trajneri i të kuqve, Skënder Gega ka dalë para mediave për të folur për ndeshjen, por edhe për çështje të tjera ku ka përmendur Trashin, me Skënderbeun, por edhe tifozët. "Jemi aty, një pikë mbrapa dhe kemi analizuar gjithçka në detaje. E dimë arsyen pse humbëm, por e kemi potencia-

lin të ngrihem. E kemi ndërjerë përgjegjësinë dhe keqardhjen për atë ndeshje, por gjithsesi do të vazhdojmë për ndeshjen e radhës. Deri tani jam jashtëzakonisht i kënaqur dhe ndihem krenar për çunat dhe për çdo gjë. Nëse dikush ka pasur diçka ose është sqaruar në mo-

ment ose pas ndeshjes, apo dhe gjatë ndeshjes, kur jam mundur që t'i jap një mesazh. Jemi bashkë si kur humbasim, ashtu edhe kur fitojmë. Me Kamzën nuk kemi rrugë tjetër. Kemi punuar këto ditë dhe do mundohemi ta ndërtojmë në atë mënyrë për të marrë

maksimumin. Dënimi? E shoh të paarsyeshme që të dënohet një tifozeri e tërë, është një humbje e madhe. Lojtari i 12-të janë ata dhe ne e ndjejmë. Sapo dalim në fushë, shohim se ku është pjesa jonë më të rëndësishme. Perceptimet janë të ndryshme dhe unë nuk mund të

ndërhyj, por them se shqiptarët ose institucionet tona janë inferiore dhe ulin kokën para gjërave që ndodhin karshi fqinjëve tonë. Të gjithë e shohim se çfarë ndodh në futbollin në Ballkan se si na digjet flamuri dhe si na ofendojnë dhe s'kam dëgjuar se është dënuar fusha në Greqi ose në Serbi. Është mendimi i tyre, por them se është i gabuar dhe na kanë dënuar dhe na kanë hequr një pjesë shumë të rëndësishme", tha ndër të tjera trajneri i Partizanit.

Gega: Kemi institucione inferiore që ulin kokën

Verilindorëve nuk u bëjnë punë as tifozët, vlonjatët u bëhen "pullë poste" në renditje

Flamurtari thyen Kukësin, Bicaaj "ekzekuton" Tiranën

Mbrojtësi me dy gola përmbysi avantazhin bardheblu



Jeton Selimi

Flamurtari ia del të thyejë Kukësin, me këtë të fundit që nuk mundi të përfitojë as nga mbështetja e tifozëve për herë të parë në këtë sezon. Në takimin aq shumë të përfolur, të cilin duhej ta gjykonte kryesori Blerim Ziri, vlonjatët arrijnë suksesin e parë që përpara sfidës, duke detyruar FSHF-në të ndërrojë gjyqtar, pasi Ziri është i afërm i Ramadan Ndreut, drejtorit të Kukësit. Ndaj sfida ndërroi bilbil, i cili iu besua Olsi Sokoliti. Kështu, pas këtij lëmshi të FSHF-në, nis ndeshja në Kamzë, me presidentin Gjici që kish të hapur dyert për tifozët, shumica e të cilëve janë banorë të ardhur nga qarku i Kukësit. Por, as kjo nuk rezultoi ilaç efikas, pasi Flamurtari është zot në fushë në pjesën e parë, duke e vënë Kukësin me shpatulla pas murit dhe duke gjetur dy gola, fillimisht me Velium në minutën e 39-të dhe më pas me Danilo Alveshin në të 43-ën, çka i lejoj kuqezinjët vlonjatë të shkonin në dhomat e zhveshjes. Kukësi do të kërkojë të rikthehet në ndeshje dhe këtë e bën më së miri me golin e minutës së 49-të, ku realizoi Shpehar, ndërsa më pas sfida ndonëse prodhoi raste në të dyja portat, nuk solli më gola, me Fl-



amurtarin që gjen fitoren dhe ngjitet në kuotën e 18 pikëve, një më pak sesa Kukësi që mban vendin e tretë në tabelë me 19 pikë. Bicaaj "ekzekuton" Tiranën Problemët e Tiranës fillojnë që pa nisur ndeshja. Tifozëria e organizuar bardhe-

blu, "Tirona Fanatics" detyrohet të braktisë stadiumin "Tofik Jashari" të Shijakut, pas ndërhyrjes së policisë për të hequr një banderolë kundër presidentit Halili, banderolë që i shoqëron ultrasit e Tiranës prej shumë ndeshjesh, por në Shijak ka

SUPERLIGA		
TË PREMTEN		
Teuta - Tirana		2-1
Kukësi - Flamurtari		1-2
TË SHTUNËN		
Luftëtari - Laçi		14:00
Partizani - Kamza		17:00
Skënderbeu - Kastrioti		17:00
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Skënderbeu	10	23
Partizani	10	22
Kukësi	11	19
Flamurtari	11	18
Teuta	11	18
Laçi	10	16
Tirana	11	9
Luftëtari	10	9
Kamza	10	8
Kastrioti	10	4

Tirana luan më mirë se Teuta në pjesën e parë dhe e sheh veten në epërsi në minutën e 28-të, kur harkimi i Hasanit gjen shtyllën dhe devijohet nga Shkalla në rrjetë, i cili shënon kështu një autogol. Me fillimin e pjesës së dytë është Teuta që jo vetëm rikthen baraspeshën, madje arrin përmbysjen e madhe. Fillimisht barazon me anë të qendërmbrojtësit Ditmar Bicaaj, që shtyn në rrjetë topin e mbetur në zonë pas zhvillimit të një këndoreje, ndërsa 120 sekonda më pas shënon një gol mjaft të bukur me kokë, duke u kthyer kështu në ekzekutorin e Tiranës. Bardheblutë përpiqen, madje kishin dy mundësi të arta me Hasanin dhe Grezdenë që të barazonin, por Hidi u përgjigj në mënyrë kolosale, duke mbrojtur fitoren e çmuar, që e bën Teutën të ruajë hapin e Flamurtarit në kuotën e 18 pikëve, ndërsa Tirana mbetet në zonën e ftohtë të renditjes me 9 pikë.

TRAJNERI I FLAMURTARIT



Daja i lumtur: Kemi rikuperuar shumë pikë

Flamurtari ka marrë një fitore shumë të rëndësishme ndaj Kukësit. Një fitore me shumë vlera, pasi është arritur në transfertë, ndërkohë që edhe situata para ndeshjes nuk ishte shumë e mirë, aq më tepër pas pezullimit të Bathës. Trajneri Ilir Daja, pas fitores në stadiumin e Kamzës, ka theksuar se skuadra e tij luajti mirë dhe në tri javët e fundit ka rikuperuar goxha pikë: "Në pjesën më të madhe të ndeshjes e kemi vënë në vesh-tirësi kundërshtarin. Natyrshëm që në 15 minutat e fundit ishte iniciativa e kundërshtarit për të barazuar, por arritëm ta mbronim rezultatin. Bëmë një lojë si me Teutën, por në një minutazh më të madh. Në këto tri javët e fundit kemi 2 fitore dhe 1 barazim. Kemi rikuperuar shumë mirë në aspektin e pikëve dhe duam që këtë mënyrë loje ta ruajmë edhe në javët e ardhshme. Vazhdimësia është elementi që iu duhet ekipit në këtë moment. Nga lojtarët më eksperiencë presim më shumë, janë ata që duhet ta udhëheqin ekipin", - ka theksuar trajneri Daja mes të tjerash.

TRAJNERI I TIRANËS

Trajneri i Tiranës, Ardian Mema, u duk qartë se ishte shumë i pezmatuar për mënyrën si u humb ndeshja me Teutën. Ai nuk deshi të justifikohet, por ka akuzuar arbitrin për vendimet e tij. "Të vjen keq, sepse janë 10 raste të humbura, nuk di të gjej fjalë çfarë të them për pjesën e lojës. Ekipi u shpreh mirë, kemi luajtur, kishim raste për shënim. Një problem ishte edhe pjesa e arbitrit, nuk e kuptoj se çfarë kish të, loja ishte e qetë, filloi të jepte faulle dhe e afroi ekipin kundërshtar me

Mema e ka me fatin e keq edhe me arbitrat



portën tonë. Nuk dua të justifikohem me arbitrin, por nuk shkon kështu. Tirana nuk ka nevojë që ta ndihmojë kush, as

mua, thjesht të marrë atë që meriton në fushë. Duhet gjetur një lloj zgjidhjeje, që nuk e di edhe unë në këto momente, dua të shikoj edhe një herë me qetësi ndeshjen, do të nxjerr problematikat që ka pasur ekipi sidomos në sulm, se kemi humbur shumë gola para portës. Pjesa tjetër janë defektet e gabimet që kemi bërë, sidomos në goditjet standarde", - theksoi trajneri Mema.

TRAJNERI I KUKËSIT

Trajneri i Kukësit, Armando Cungu në përfundim të takimit ndaj Flamurtarit, është shprehur për "Supersport" se ekipi i tij pëson gola amatorë, ndërkohë që ka edhe pakënaqësi me gjykimin. "Nuk ka vend për keqardhje, mund të gabohesh një herë e dy, kur vazhdon në vazhdimësi me gabime amatore. U dhurojmë golat kundërshtarëve që na vënë në presion. Kundërshtari erdhi për të shfrytëzuar shtat-


Cungu pa doreza: I lumtë kundërshtarit që ndërron arbitrin



lartësinë e tyre, goditjet standarde. Edhe pse kemi punuar gjatë javës, përsëri

gabojmë. Edhe në golin e dytë ekipi humbi toruan e ekuilibrin, me pak forca mbrapa. Habitem nga dëshira për të shënuar e nuk mbron e pëson. Në pjesën e dytë, kundërshtari kishte marrë masat në çdo aspekt, jo vetëm në fushën e lojës. U lumtë kundërshtarëve, janë të aftë të ndryshojnë gjyqtarët e ndeshjeve dhe të vendosin ata që kanë preferencë".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Janë llogari.
- Kufizojnë një trup.
- Janë nocionet e para.
- Janë vendet si Katar.
- Shkruajnë nga e djathta në të majtë.
- Një pije... dardhe.
- Janë me marka në armatura.
- Artikull spanjoll.
- Një pjesë e sadistëve.
- Janë shemra.
- Mund të jenë informacioni.
- Fillojnë javën.
- Janë në Marrakesh.
- Janë dhoma.
- Një Ardan guvernator i Bankës.
- Demek s'ka kufij.
- Janë centralet si Chernobyl.
- Mbyllin një dyqan.
- Një impiant hi-fi.
- Rolet pa pare.
- Një pjesë e parlamentit.

- Kufizojnë një send.
- De Filippi e Amici.
- Pagëzoi Shën Palin.
- Ushtrohet një me tryzni.
- Victorien dramaturg.
- Eshtë edhe ai i Zi.
- Fillojnë tatëpjetën.

VERTIKAL

- Hunt aktore.
- Nolde piktor.
- Gjysmw siklet.
- Marsi në Areopag.
- Janë antena satelitore.
- Rrihet në fund.
- Pak tebaizëm.
- Janë taksat.
- Një test.
- Ferrara regjisor.
- Eshtë luftë.
- Kufizojnë citatet.
- Një lëndë e organizmit.
- Qureshin edhe Eumenide.
- Ai i bardhë është quajtur David Bowie.
- Eshtë si baba.
- Julia i Familja Addmas.
- Jules shkrimtar.
- Mafia pa zëm.
- Role pa zëm.
- Eshtë zbulim në skenë.
- Inicialet e Morricone-s.
- Irene aktore.
- Kufij në Oslo.
- George shkrimtare.
- U shkrua nga Emile Zola.
- U shit për një pjatë tjerza.
- Film shqiptar.
- Me të nxjerrin trarë.
- Bega komik.
- Eshtë yll i skuadrës.
- Fillojnë ndeshjen.
- Satelit i Uranit.
- Inicialet e Dukas kompozitor.
- Mbarojnë fare.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Ndan kapitujt
- Emri i Gonçarov.
- Eshtë e hollë dhe therëse.
- Inicialet e Stone regjisor.
- Eshtë edhe ajo mistral.
- Kryeqyteti i Marokut.
- Ki Moon në OKB.
- Eshtë lloj papagalli.
- Një pjesë e amerikanëve.
- Gjysmë tandem.
- Hapet me trapano.
- Një sigël maunesh.
- Ishtë djali i Odiseut.
- Eshtë sherr në shtyp.
- Artikull spanjoll.
- Eshtë zog i verdhë.
- Mund të jetë kuzhine.
- Inicialet e Lattuada regjisor.
- Eshtë shtet i papës.
- Mbeten në fund.
- Pesci aktor.

VERTIKAL


- Një bukanier.
- Mosketieri jezuit.
- Janë zënë në lustë të tillë.
- Pak analogji.
- Gishti pa shi
- Në radhë të parë.
- Tiriac që qe tenist.
- Tregohet nga busulla.
- Kaçaturian kompozitor.
- Fillojnë natën.
- Vallëzon me tutu.
- Janë ata që nuk kanë shumë gjak.
- Mund të jenë kursimi.
- Janë katër në violinë.
- Janë vendet e pazëna.
- Në mes të Edgar dhe Poe.
- Janë ato që na përkasin.
- Këngëtare italiane.
- Një pjesë e pavjionit.
- Braktisi Didonën.
- Mune të jenë lubrifikantë.
- Lumë në Francë.
- Kush është... do të pijë.
- Nolde piktor.
- Parashtesë zvogëluese.
- Zanore arabe.
- Rastet pa set.
- Pak dramatike.
- Maket pa kufij.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Inicialet e Moravia-s.
- Kështu përfundin një polic.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

A	R	M	A	N	D	L	I	N	D	A
V	A	J	I	E	M	V	E	K		
A	D	E	N	L	A	K	E	O	A	Z
T	A	K	M	I	L	I	T	A	N	T
R	A	P	I	R	A	M	I	D	A	L
A	F	I	N	E	R	I	T	E	L	
F	A	N	A	T	I	K	E	T	H	I
D	E	N	A	R	A	E	G	E	G	
E	A	J	E	H	E	R	O	N	J	
M	A	R	I	A	N	A	P	T	N	E
E	T	E	R	I	K	E	T	A	A	
K	A	T	A	R	A	K	T	I	A	T

FJALËKRYQI (1)

A	D	A	M	I	R	E	F	O	R	M	A	T
R	E	K	O	R	D	M	E	N	E	L	A	U
S	R	T	P	E	K	I	N	M				
E	R	O	S	K	A	N	O	T	A	Z	H	I
N	T	R	P	O	L	E	M	I	K	A	T	A
E	C	P	E	R	I	M	E	T	E	R	M	
K	R	I	J	I	M	N	A	A	T	E		
E	I	K	R	E	T	I	N	G	R	I	D	
I	N	A	T	E	R	A	L	I	L	I	G	U
M	A	T	E	R	U	M	O	A	Z			
L	E	G	J	E	N	T	U	O	N	A		
E	T	E	A	L	T	A	R	E	T	I		

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

7	2			8	3			
5				6				8
	3	6	4		7			9
9	1		3	2				
			6	7		1		9
	7	2					3	5
			5	3	8			
2							5	
								1
8								

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	1	4	6	3	8	7	5	9
8	5	9	1	7	4	6	2	3
3	6	7	9	2	5	4	8	1
5	2	1	4	6	3	8	9	7
9	4	3	2	8	7	1	6	5
6	7	8	5	1	9	3	4	2
7	8	5	3	4	2	9	1	6
1	3	2	8	9	6	5	7	4
4	9	6	7	5	1	2	3	8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Njeriu mentar nuk flet për veten e tij dhe për punë që i përkasin atij vetë
- Rruga e jetës është drejtësia, mos u ndaj nga rruga për të hyrë nëpër rrugica
- Miqësia është si drita e shkrepëtimës; sa më i errët të jetë vendi, aq më shumë ndriçon
- Nuk i takon gjë dhëmbit të skiles që qëndron e mbyllur në strokfun e vet
- S'ka njeri të pafajshëm në botë; i mëncuri nuk i thotë djalit mos gabo, por e këshillon të gabojë sa më pak



KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

18	3		1	6	9	8	11	8	16	4	8	S	U	P	A	I	K	K	U	R	S	I		
18	5	16	4	12	7	3			2		1	14	A	P	E	R	A	T	U	R	A	H	K	
8	I	6		3		11	8	8	9	6	1		T	T	O	P	A	T	P	A	P	A	S	
3	R		9	5	2	7	3	12	8	9	13	12		K	E	M	A	L	T	A	K	A	I	
9	K	5	2	7	3	1	4	8	15	1	4		P	A	R	E	T	I	T	R	U	R	I	
	9	6	8	12	8	9	7			6	10		R	P	I	A	M	E	L	I	A	S		
4	3	5	9	7		8	3	5	12	8	9	7	E	T	A	T	E	T	L	S	H			
3		16	1	6	4		7	15	8	4	1		P	O	N	Y	E	R	I	I	U	T		
8	4	1	6	6	1		16	7		7	12	1	I	L	T	Y	M	I	E	M	K	E		
13		6	7			11	1	7		4	1	18	T	I	R	A	N	E	T	R	I	M	A	T
11	1	7		17	7	1	12	6	8	17	1		E	N	T	I	T	A	N	I	K	E	E	
10	13	4	13	3	8	16	4	7	4		1	3	T	A	U	E	T	K	U	R	A	T		

Thënie të mënçura

- Bota është një shesh i ekspozuar shiut dhe erës; ai që në këtë shesh e ruan dritën e përpjekjes e të kuptimit dhe nuk e shuan, është filozof i vërtetë
- Ajo që qeveris botën nuk është as forca, as ligji, por është mirësjellja dhe edukata
- Zgjuarësia është një dritë hyjnore, ndriçimi i së cilës ndrit jo vetëm sipërfaqen e sendeve, por edhe brendinë e tyre
- Një kokërr gruri nuk e mbush dot hambarin, por ndihmon kokrrat e tjera që e kanë mbushur

